

WA KALA RABBUKUM UD' UNI ASTAJIB LAKUM...

ZOTI JUAJ THA: "LUTMUNI MUA, DO JU PËRGJIGJEM!..."

Kur'ani Kerijm, Sureja: EL-GÂFIR, Ajeti: 60

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIMI SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.130 SHKURT 2019



REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR

Syrja Xhelaj

REDAKTORË

Nuri Çuni

Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT

Jakup Gjoca - Greqi

Eugen Shehu - Zvicër

Përparim Kapllani - Kanada

Agim Cani - Gjermani

Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË

Arian Leka

Zenel Anxhaku

Blerina Harizaj

Agim Zeka

Besnik Anxhaku

DESIGN

Studiograf "A&N"

SHTYPET NË
SHTYPESHKRONJËN

"Urtësia

Bektashiane"

Shkurt, 2019



WA KALA RABBUKUM UD'UNI ASTAJIB LAKUM...

ZOTI JUAJ THA: "LUTMUNI MUA, DO JU PËRGJIGJEM!..."

Kur ani Kerijm, Sureja: EL-GAFIR, Ajeti: 60

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM JOURNALISË SË SHENJITË TË
KRYEGJYSHATËS BËKTASHIANE
NR.130 SHKURT 2019

Duaje me frymën Tënde!

Duaje me frymën Tënde!

Mësimi që mora ishte befalusës, ose i thënë ndryshe shumë i qartë jo vetëm në kontekstin ballkanik por edhe për bashkëbesimtarët e mi në Azerbajxhan. Lideri bektashian më spjegoi se në haxhin e lamtumirës, i Dërguari i Allahut, shpalli midis shumë xhevahireve të tjerë edhe dy trashëgimitë shpirtërore më të çmuara.




32 Nr. 130 /

33

Mësimi që mora ishte befalusës, ose i thënë ndryshe shumë i qartë jo vetëm në kontekstin ballkanik por edhe për bashkëbesimtarët e mi në Azerbajxhan. Lideri bektashian më spjegoi se në haxhin e lamtumirës, i Dërguari i Allahut, shpalli midis shumë xhevahireve të tjerë edhe dy trashëgimitë shpirtërore më të çmuara.

"Urtësia" mbushi 25 vjet

"Urtësia" mbushi 25 vjet



Në fund të nëntorit të vitit të shkuar, në mjediset e "Tirana-Internacional" në Tiranë, u zhvillua ceremonia e 25 vjetorit të daljes së numrit të parë të revistës urtësia, organ i Kryegjyshit Botëror Bektashian, në këtë aktivitet, të zhvilluar nën përkujdesjen e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj,...

Diç e madhe për bektashinjtë



Dy ngjarje të rëndësishme ishin objekt i aktivitetit më 17 janar të këtij viti në mjediset e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë: Përkujtimi i 98 vjetorit të Kongresit të Parë Bektashian të Prishtës dhe akordimi nga Presidenti i Republikës i dekoratës "Nderi i Kombit" për klerikun e njohur bektashian, Sali Niazi Dedei.

16 shkurti, si një behar i përjetshëm



Në atë relief të mrekullueshëm të teqesë së madhe të Elbasanit, midis heshtjes së pishave dhe zhaurimës së Shkumbinit, dëgjoj zëra myhibësh e dervishësh, të cilët kanë ardhur në këtë 16 shkurt pranë shenjtërisë së tyrebe.

Dede Reshat Bardhi për Dede Ahmet Myftarin



Nuk mund të jetonin të dyja së bashku edhe diktatura edhe ligje të tjera. Prandaj këtu poshtë kish nisur shkatërrimi. ...

“Urtësia”



Presidenti Ilir Meta nderon revistën “Urtësia” me titullin “Naim Frashëri”

Nga Kujtim Boriçi

Në fund të nëntorit të vitit të shkuar, në mjediset e “Tirana-Internacional” në Tiranë, u zhvillua ceremonia e 25 vjetorit të daljes së numrit të parë të revistës urtësia, organ i Kryegjyshit Botëror Bektashian. Në këtë aktivitet, të zhvilluar nën përkujdesjen e Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, morën pjesë Presidenti i republikës, Shkëlqesia e Tij, Ilir Meta, Kreu i myslimanëve shqiptar Skënder Bruçaj, përfaqësues të feve të

tjera në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, deputetë të Kuvendit Popullor, intelektualë e besimtarë të shumtë. Në këtë aktivitet, Presidenti Ilir Meta ka vlerësuar Revistën bektashiane “Urtësia” me titullin “Naim Frashëri”. Në ceremoninë me rastin e 25-vjetorit të Revistës, ku të pranishëm ishin Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, kreu i Bashkësisë Myslimane Skënder Bruçaj, klerikë të besimeve të tjerë fetarë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, besimtarë të shumtë nga të gjitha trevat mbarëshqiptare, përfaqësues të medieve etj, kreu i shtetit dekoroi revistën me Urdhërin “Naim Frashëri”.

mbushhi 25 vjet



Në fillim fjala përshëndetëse ju dha Kryegjyshit Botëror Bektashian, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili ndër të tjera tha: "...Më lejoni në radhë të parë t'ju falënderoj për pjesëmarrjen Tuaj në këtë jubile kaq domethënës që lidhet drejtpërdrejt me të vetmen revistë fetare,

shoqërore dhe artistike, "Urtësia", organ zyrtar i Kryegjyshit Botëror Bektashian. Personalisht lutem që Zoti i Lartë ju pastë në vëmendjen e Tij, jo vetëm për devocionin fetar që rrëfeni, por edhe për respektin ndaj fjalës së urtë që bën mrekullira! Besoj se të gjithë ne që ndodhemi në këtë sallë, e

dimë fort mirë se një çerek shekulli më parë, mjedisi ku u lind kjo revistë nuk ishte aq i ngrohtë dhe entuziast. Dhe kjo ishte e natyrshme se vinim nga një regjim që jo vetëm ndaloi fjalën e Zotit, por anatemoi, lëndoi, burgosi dhe pushkatoi të gjithë ata që fjalën e Tij, e shpallën si të pavdekshme dhe të gjithëpushtetshme.

Besimtarët bektashianë, së bashku me udhëheqësit shpirtërorë të tyre, sikundër edhe ata synitë, të krishterë katolikë e ortodoksë, ndonëse u përplasën me ligjet dhe qëndrimet më paranojakë të ateizmit, sërish nuk e humbën as shpresën dhe as orientimin. Kibleja e tyre ishte dhe mbeti, dashuria e fshehtë për Krijuesin, për



njeri-tjetrin. Solidariteti ynë fetar i kapërceu pengesat qesharake të regjimit. Por edhe në situata të tilla, fjala e Haxhi Bektash Veliut, amaneti i brezave të tërë të dervishëve e baballarëve bektashinj, historia e shkëlqyer e tarikatit tonë, duheshin nxjerrë në dritë të diellit, duheshin bërë ët ditura dhe duheshin respektuar jo thjeshtë si trashëgimi, por si një ndihmesë e pa llogaritshme në sfidat që na prisnin. Dalja e numrit të parë të urtësisë, u sanksionua nga Kongresi i gjashtë bektashian, i mbajtur në Tiranë në korrik të vitit 1993, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve bektashianë e gati 18

shteteve. Por unë personalisht mbaj mend përkujdesjen e klerikëve si: baba Neki Çaushaj, baba Bajram Mahmutaj, baba Sherif Canaj, baba Selim Kaliçani, të cilët, nën udhëheqjen shpirtërore të dede Reshat Bardhit, me frymën e mirësisë dhe të urtësisë tradicionale bektashiane, e bekuan qysh në djep këtë revistë, duke i uruar asaj fat të bardhë në udhëtimin e saponisur. Revista "Urtësia" në këtë udhëtim çerek shekullor, i është përmbajtur me devotshmëri frymës me të cilën u bekuq, duke u shndërruar në interprete të ideve, pikëpamjeve si dhe prirjeve të Selisë sonë të Shenjtë, misioni dhe përgjegjësia e së cilës i kalon kufijtë e Ballkanit dhe të Europës, madje shkon deri më tej, pranë komuniteteve të besimtarëve bektashianë në Kanada, Australi dhe Shtetet e Bashkuara të

Personalisht lutem që Zoti i Lartë ju pastë në vëmendjen e Tij, jo vetëm për devocionin fetar që rrëfeni, por edhe për respektin ndaj fjalës së urtë që bën mrekullira! Besoj se të gjithë ne që ndodhemi në këtë sallë, e dimë fort mirë se një çerek shekulli më parë, mjedisi ku u lind kjo revistë nuk ishte aq i ngrohtë dhe entuziast. Dhe kjo ishte e natyrshme se vinim nga një regjim që jo vetëm ndaloi fjalën e Zotit, por anatemoi, lëndoi, burgosi dhe pushkatoi të gjithë ata që fjalën e Tij, e shpallën si të pavdekshme dhe të gjithëpushtetshme. Besimtarët bektashianë, së bashku me udhëheqësit shpirtërorë të tyre, sikundër edhe ata synitë, të krishterë katolikë e ortodoksë, ndonëse u përplasën me ligjet dhe qëndrimet më paranojakë të ateizmit, sërish nuk e humbën as shpresën dhe as orientimin. Kibleja e tyre ishte dhe mbeti, dashuria e fshehtë për Krijuesin, për njeri-tjetrin. Solidariteti ynë fetar i kapërceu pengesat qesharake të regjimit. Por edhe në situata të tilla, fjala e Haxhi Bektash Veliut, amaneti i brezave të tërë të dervishëve e baballarëve bektashinj, historia e shkëlqyer e tarikatit tonë, duheshin nxjerrë në dritë të diellit, duheshin bërë ët ditura dhe duheshin respektuar jo thjeshtë si trashëgimi, por si një ndihmesë e pa llogaritshme në sfidat që na prisnin. Dalja e numrit të parë të urtësisë, u sanksionua nga Kongresi i gjashtë bektashian, i mbajtur në Tiranë në korrik të vitit 1993, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve bektashianë e gati 18 shteteve. Por unë personalisht mbaj mend përkujdesjen e klerikëve si: baba Neki Çaushaj, baba Bajram Mahmutaj, baba Sherif Canaj, baba Selim Kaliçani, të cilët, nën udhëheqjen shpirtërore të dede Reshat Bardhit, me frymën e mirësisë dhe të urtësisë tradicionale bektashiane, e bekuan qysh në djep këtë revistë, duke i uruar asaj fat të bardhë në udhëtimin e saponisur.

Amerikës. Përmes kësaj fryme, ajo solli në faqet e saj zhvillimet më kryesore të bektashizmit, duke hedhur dritë në mënyrë të veçantë në traditën emblematike të

rastin të falënderoj kryeredaktorin e sotëm, zotin Syrja Xhelaj, i cili nga viti 2004 dhe deri sot, pra prej 14 vitesh pa ndërprerje, ka bërë të mundshme t'i japë “Urtësisë”

“Dita e sotme, jubileu i mbarë i daljes në dritë të “Urtësisë”, ofron për të gjithë ne, një det’ valësh të ndjesive të mrekullueshme, të kthyer tanimë në baticë kujtimesh. Njerëzit kanë nevojë për kujtime, siç kanë nevojë për ajër. Revista “Urtësia”, në çdo këndvështrim është kuintesenca e një çerek shekulli plot sakrificë, brenda të cilit koha, me kryeneçësinë e saj, vuri në provë jo thjeshtë Selinë e Shenjtë Bektashiane këtu në Tiranë, por vetë frymëmarrjen ekzistenciale të tarikatit tonë, të shpërndarë sot në më shumë se 31 vende në të gjithë kontinentet ku ushtrohet besimi. Në vitet ‘90 të shekullit që lamë pas, së pari ne duhej të ringrinim besimin, të goditur për jetë a vdekje nga krahura ateiste. Na duhej të çelnim dritare për të parë larg, shumë larg se realiteti i trishtë që jetonim, ndofta për ato hapësira ku për vite me radhë kishim bashkuar ndjesitë tona me krahët e zogjve. Pikërisht në këtë kontekst, revista “Urtësia”, merr përsipër misionin e saj historik.



tarikatit tonë 800 vjeçar. Kjo revistë është përpjekur dhe përpjetë vazhdimisht që kodin zakonor dhe traditat e hershme mos t'i shohë e trajtoj si relike muzeale, por si një sendërtim natyral të tyre në përshtatje me kushtet dhe kohën që po kalojmë. Kësaj, vlerat universale të bektashizmit vijnë duke u pasuruar nga viti në vit dhe nga një brez besimtarësh tek tjetri. Ndërkaq, vlen të kujtoj për të gjithë ju se “Urtësia” në këto 25 vjet, ka dhënë kontributin e vet të çmuar edhe në kontekstin e dialogut ndërfaqetor shqiptar, apo në atë proces të rrallë të botës së sotme, të cilën Shenjtëria e Tij, Papa Françesku, e cilësoi në Tiranë si “vëllazëri fetare.” Në faqet e kësaj reviste kanë zënë vend të merituar figura të shquara klerikësh qofshin syni, katolik, ortodoks apo ungjillorë, të cilët i kanë shërbyer Zotit dhe kombit, përmes një ndjenje të fuqishme vëllazërimi fetar. Më vjen mirë të përmend sot në këtë fjalë, kontributin e dy kryeredaktorëve të parë, Hysen Ibrahimit dhe Kujtim Ahmataj, të cilët bënë sa ishte e mundur që revista “Urtësia” të kishte fytyrën e saj, të dashurisë dhe mëshirës universale myslimane, të kishte zërin e klerikëve të nderuar bektashianë, të kishte vetë jetën e teqeve tona anë e kënd botës. Sikundër gjej

jo vetëm krenarinë e besimit që përfaqësojmë, jo vetëm hapësirat bashkëbiseduese doktrinale, por edhe mendimin e kulluar intelektual, të përcjellë kurdoherë nën një vështrim të paqtë. Ndihamë e zotërinjve Nuri Çuni, Kujtim Boriçi, Jetmir Bodini, si edhe dhjetëra bashkëpunëtorëve të revistës tonë, padyshim që e kanë bërë “Urtësinë” të respektuar dhe të dashur për çdo lexues.”

Më pas, fjala iu dha gazetarit Syrja Xhelaj, kryeredaktor i revistës ‘Urtësia’, i cili ndër të tjera theksoi: “Dita e sotme, jubileu i mbarë i daljes në dritë të “Urtësisë”, ofron për të gjithë ne, një det’ valësh të ndjesive të mrekullueshme, të kthyer tanimë në baticë kujtimesh. Njerëzit kanë nevojë për kujtime, siç kanë nevojë për ajër. Revista “Urtësia”, në çdo këndvështrim është kuintesenca e një çerek shekulli plot sakrificë, brenda të cilit koha, me kryeneçësinë e saj, vuri në provë jo thjeshtë Selinë e Shenjtë Bektashiane këtu në Tiranë, por vetë frymëmarrjen ekzistenciale të tarikatit tonë, të shpërndarë sot në më shumë se 31 vende në të gjithë kontinentet ku ushtrohet besimi. Në vitet ‘90 të shekullit që lamë pas, së pari ne duhej të ringrinim besimin, të goditur për jetë a vdekje nga krahura ateiste. Na duhej të



“Kjo revistë është tashmë zëri, forumi dhe shpirti i vërtetë i aktivitetit të Kryegjyshit dhe bashkësisë tuaj të nderuar. Botuesit e respektuar të kësaj reviste, nën drejtimin e Kryegjyshit Botëror i kanë ofruar publikut me shkrimet e tyre cilësitë më të mira të bektashianëve si atdhedashurinë, mistikën e hollë dhe harmoninë me besimet e tjera fetare.” Revista “Urtësia” është vazhduese e traditës së teologëve dhe poetëve të mëdhenj të Rilindjes që nga Naim Frashëri, Baba Ali Tomori me gazetën “Reforma”, deri tek Musine Kokalari. Në 130 numrat e saj, revista i ka përcjellë lexuesit qëndresën dhe triumfin e besimit bektashian..”

çelnim dritare për të parë larg, shumë larg se realiteti i trishtë që jetonim, ndofta për ato hapësira ku për vite me radhë kishim bashkuar ndjesitë tona me krahët e zogjve. Pikërisht në këtë kontekst, revista “Urtësia”, merr përsipër misionin e saj historik. Unë përfytyroj me një kthjelltësi të çuditshme, një mbrëmje të ftohtë

dhjetori të vitit 1993, që ndërsa zjarri në kafeoxhakun e Kryegjyshitës po shuhej, ndizeshin shkëndijat e një meraku. Si do të quhej kjo revistë e bektashinjeve? Çfarë e kishte mbajtur gjallë këtë tarikat nëpër rrjedhat e kohërave plot luftëra fetare, mëri të zymta etnike, konflikteve të fshehtë dhe të hapur midis ortodoksisë synite

dhe kumteve të lirisë që shpërndante mençuria e Haxhi Bektash Veliut? Si do të mund të ecte ky lum i mistizmës islame dhe traditës së baballarëve bektashinj, përmes ligjeve të kohërave moderne” Dikush nga baballarët e pranishëm, duke shtyrë urët e zjarrit në vatër thuajse këndoi, vargjet e të parit poet bektashian, Jonuz Emre: “Pa duar, kundër atyre që na qëllojnë, / Pa fjalë, kundër atyre që na mallkojnë. /

Ky kumt fatsjellës, pa u kuptuar si duhet në brigjet e Azisë dhe Anadollit në shekujt e 13 e 14, kish udhëtuar drejt viseve shqiptarë, në Ballkanin e trazuar, përmes misionit bektashian. Titulli i revistës u shpall butësisht dhe u pranua me një ngazëllim të skajshëm: Urtësia! Në mënyrë krejt intuitive ata, të parët dhe të mençurit baballarë të asaj nate dhjetori të vitit 1993, e patën kuptuar se emri i revistës përpara se të mëshironte kredon estetike, devocionin ndaj Krijuesit, gjenezën identare dhe mozaikun e tarikatit, vlente të ishte një majë shumë e vështirë për t’u arritur nga

njeriu: Urtësia! Duhet vite të tëra drite, udhëtim drejt vetes, të mund t'i afroshesh urtësisë. Sa rrallëkund në historinë e letrave botërore, këshilli botues i një reviste, identifikohet me këshillin gjyshëror bektashian. Ky identifikim ka shërbyer si fat që e shoqëron revistën ende sot. Personalisht, nuk do më hiqen kurrë nga mendja, fjalët e dede Reshat Bardhit, fundmajin e vitit 2004, ndërsa ulesha ën zyrën e kryeredaktorit të revistës: “Biri im! Për gazetari nuk të jap mend. Por më dëgjo një fjalë. Tek ‘Urtësia’ flasim shumë. Vërua veshin të gjithëve, por dervishët dhe baballarët e mijë t’i duash ndryshe të tjerëve. Me ata e kam jetën unë. Me ata e mbajmë gjallë frymën e Haxhi Bektash Veliut.. Ata janë të urtët e Zotit dhe fati i robit!”. Një konveccion i tillë, dhënë përmes një këshille sqimtare, më ka shërbyer kurdoherë ti shoh klerikët bektashi-

prej nga mund të udhëtosh nëpër mistikën drithëruese dhe filozofike, sepse në fund të fundit perceptimi më i kthjellët literalisht për të, është dashuria për urtësinë. Jo më kot, i famshmi Heiderger thotë se filozofia kërkon vëmendjen tonë, pëshpërit emrat tanë, na thërret të dalim prej vetes dhe të përballemi me vetë qenien. Elitarizmit shpirtëror ekzoterik të klerikëve bektashinj të shfaqur jo rrallë në udhëtimin 25 vjeçar të “Urtësisë” është e pashmangshme t’i shkëputësh befasimet e këndshme, të ardhura prej studimeve apo poetëve me origjinë bektashiane, por që arrihen me artin e tyre lartësitë e epërme të letrave shqipe. Nder dhe respekt të veçantë për Dritëro Agollin, Xhevahir Spahiun, Ali Aliun, Moikom Zeqon, Ali Podrimen, Sadik Bejkon, Musa Vyshkën etj, të cilët i falën revistës sonë momente arti për t’u shpërblyer me vite bekimesh.

në SHBA, jo për t’i nxjerrë sot nga muzeu i vetëdijes sonë, por t’i kujtoj se mbeten gurë themeli në ngrehinën shpirtërore që na ka mbledhur sot, në këtë sallë. Një respekt i veçantë i dedikohet sot baba Mondit, sugjerimet e të cilit për “Urtësinë” i dëgjojmë me shumë vëmendje”.

Ndërsa Presidenti Ilir Meta, në fjalën e tij përshëndetëse, ndër të tjera tha: “Kjo revistë është tashmë zëri, forumi dhe shpirti i vërtetë i aktivitetit të Kryegjyshit dhe bashkësisë tuaj të nderuar. Botuesit e respektuar të kësaj reviste, nën drejtimin e Kryegjyshit Botëror i kanë ofruar publikut me shkrimet e tyre cilësitë më të mira të bektashianëve si atdhedashurinë, mistikën e hollë dhe harmoninë me besimet e tjera fetare.” Revista “Urtësia” është vazhduese e traditës së teologëve dhe poetëve të mëdhenj të Rilindjes që nga Naim Frashëri, Baba Ali Tomori me gazetën “Reforma”, deri tek Musine Kokalari. Në 130 numrat e saj, revista i ka përcjellë lexuesit qëndresën dhe triumfin e besimit bektashian..”

Më pas, fjala iu dha drejtorit të gazetës “Telegraf”, njëkohësisht kryetar i shoqatës ‘Tomorri’ dhe kryetar i jurisë së çmimeve vjetore të revistës ‘Urtësia’, z. Engjëll Musai. Në emër të jurisë, ai shpalli këto fitues në gjini të ndryshme, duke u dhënë certifikatat përkatëse dhe vlerat monetare për çmimin e fituar.

Grupi lab Çipini, me koncertin e dhënë ia shtoi më tej bukurinë aktivitetit.



anë si bashkëbisedues të sinqertë në faqet e revistës, njëherazi edhe si aktorë të një realiteti fetar dhe kulturor të caktuar. Çdo bisedë me ta, i shëmbëllen një dere të hapur,

Së fundmi, pa dashur të shënoj një hierarki vlerash përshëndes edhe paraardhësit e mi si: Shyqyri Skënderi, Hysen Ibrahimin përtej qiejve dhe Kujtim Ahmatajn përtej oqeanit



Ditë e madhe për bektashinjtë



Dy ngjarje të rëndësishme ishin objekt i aktivitetit më 17 janar të këtij viti në mjediset e Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë: Përkujtimi i 98 vjetorit të Kongresit të Parë Bektashian të Prishtës dhe akordimi nga Presidenti i Republikës i dekoratës “Nderi i Kombit” për klerikun e njohur bektashian, Sali Niazi Dedei. Këto evenimente u shoqëruan dhe me ekspozita, koncerte artistike e aktivitete të tjera të përgatitura enkas për këtë ditë. “Janë dy data të shënuara për miliona bektashinj kudo që ndodhen në botë.

Kongresi i Parë Bektashian i Prishtës, është një ngjarje e shënuar për miliona besimtarë në botë. Ndërsa vlerësimi i klerikut Niazi Dede nga Presidenti Ilir Meta, është dhe një tregues tjetër i vlerësimit shtetëror për rolin që kanë luajtur dhe luajnë në histori bektashizmi dhe klerikët bektashianë...” - pohoi mes të tjerave Kryegjyshi Botëror

Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj.

Historia e themelimit të teqesë së Prishtës është interesante, e cila në histori la gjurmë. Kjo lidhet dhe me kohën kur u themelua, pas teqesë së Frashërit. Të dhënat burimore flasin se më 1781 u ngrit teqeja e Frashërit, të cilën e drejtoi baba Nasibi Tahiri, i ditur dhe shenjtor i madh. Me fjalët e çuditshëm ai ka thënë: “Me emrin Tahir kam ardhur më parë në Malind të Skraparit, tani këtu, në Frashër e si të vdes këtu, kam për të vajtur në Prishtë ku do të bëj gjithë këto vepra mirëbërëse: Baba Tahiri para se të vinte në Frashër, ekzistonte në Malind, tyrbja e Tahir Babajt, i cili kishte ndërruar jetë në kohën e Sulltan Sulejmanit. Pasi ndërroi jetë Nasibi Tahiri, në Prishtë më 1850 shkëlqeu baba Tahir Kotobelli. Ai pati kundërshtime nga Malko Shehu për të mos e ngritur teqenë nëpërmjet përkrahësve të tij, si në fshat dhe rrethinat. Por baba Tahiri i mençur u përkrah nga besimtarët e tij dhe nga

mytesarifi i Beratit, HysenVirioni dhe e ngriti teqen.

Teqeja e Prishtë ku u mbajt Kongresi i Parë bektashian, mbart në historinë e vet sa e sa episode të lavdishëm të besimit të palëkundur në Zot, por edhe të dashurisë për këto troje. Klerikët që kanë shërbyer aty si baba Tahiri, baba Ahmeti, baba Xhaferi, baba Shabani, baba Hysejni, Baba Kamberi, baba Ali Turabiu, si edhe dhjetëra të tjerë, kanë mundur të mbajnë të ndezur çirakun e Haxhi Bektash Veliut, duke shpërndarë dritë dhe besim edhe në kohërat më të vështira të vendit tonë. Ajo dritë, ai besim, mbahti të ndezur në zemrat e të gjithëve, dashurinë e madhe, mësimin e madh se vetëm me pushkë dhe me penë mund ta shpëtojmë mëmëdheun. Nuk është aspak rastësi që rilindasit e Shqipërisë së Jugut, gjetën në teqenë e lavdishme të Prishtës, Tomorrit, Backës, Kuçit, Therepelit, Frashërit, Veliabishtit, Alipostivanit, Përmetit, Vokopolës, çerdhen e ngrohtë të tyre, gjetën libra dhe abetare, gjetën bukë, strehë e luftëtarëve të lirisë. Në kujtesën e Skraparasve do të mbeten të paharruara baballarët me famë si Baba Meleq Staravecka (Shëmbërdhenji), baba Fetahu i Backës, Dervish Iljasi për kontributin kombëtar. Duhet theksuar se Kongresi i Prishtës ishte pjesë dhe një hallkë madhore e vazhdimit të mëtejshëm të procesit të kahershëm e të pandërprerë të kontributeve të bektashinjve në luftën për liri pavarësi e përparim të popullit shqiptar. Por tashëm e zhvilluar dhe e realizuar në rrethana të reja politike dhe historike, sepse vepra e re me karakter kombëtar e bektashinjve i shërbente procesit të konsolidimit të mëtejshëm të pavarësisë së vendit dhe fuqizimit të shtetit shqiptar. Pasuesit e baba Tahirit si: baba Ahmedi në vitin 1902 solli abetaren e parë në Prishtë, sa u burgos dhe e vranë turqit osman, baba Xhaferi nga Luzati i Tepelenës, baba Shabani nga Buzi i Tepelenës, Baba Hyseni nga Panariti i Beratit (sot me Skraparin) kontribuan

në përhapjen e gjuhës shqipe. Baba Xhaferi më 1908 ngriti shkollën e parë shqipe në Çorovodë.

Ngjarjet e vitit 1913-1914 nga andartët grekë sollën pasoja rrëqethëse për popullin shqiptarë. Shtypi dhe dokumentet e kohës flasin për barbarizmat e andartëve grekë që bënë në Skrapar e gjithë Jugun e Shq-

Veliabishtit, Shëmbërdhenjit e gjithë teqetë e Jugut. Gazetën "Liria e Shqipërisë" më datën 27 mars 1915, Varf Aliu, dervish i kësaj teqeje. Ndër të tjera ai shkruan: "Prishta është një nga fshatrat e Malësisë së Skraparit, ku 60 vjet e po tëhu gjendet Shtëpi Zoti (teqe) pan-bektashiane... Këtë shtëpi të madhe hijerore që po rrëfenj e ka djegur njëherë



Nga lartësia e 98 viteve të shkuar, ne kujtojmë sot me ndjenjat e respektit më të thellë krejt ata klerikë, shtetarë, intelektualë, myhiban dhe dashamirës të tarikatis bektashian, të cilët me devotshmërinë dhe përunjësinë e tyre fisnike, vendosën piketat e para nga do të ecte tarikati ynë, duke shmangur meritë dhe keqinterpretimet otomane, për t'u mbështetur fort në identitetin dhe frymën tonë kombëtare. Emra të tillë si: Gjysh Ahmet Turani, gjysh Sulejman Gjirokastra, Ahmet baba Elbasani, Xhemal baba Përmeti, Mustafa baba Frashëri, Kamber Prishta, baba Ali Tomorri dhe baba Hajdar Qencka, të cilët paskëtaj formuan "Këshillin Atnor", i bëjnë nder jo vetëm besimit bektashian të fillimshekullit të 20, por sot e kësaj dite kanë hyrë me plot vëmendje në historinë botërore bektashiane.

ipërisë, djegie, shkatërrim, masakër, nuk shpëtuan nga kjo edhe teqetë bektashiane si: Teqeja e Prishtës, Backës, Tomorrit, Frashërit, Këçokut,

më parë qeveria turke dhe praç u ndër-tua, por mjerisht vandalët e Kostësi, duke parë që kjo Shtëpi Zoti epte dritën e zgjimit te populli i paditur shqipëtar, si në

të gjithë fshatrat edhe në Prishtë, u derdhë me egërsi: vranë, prenë, plaçkuan teqenë edhe shtëpitë e fshatit dhe iknë praptazi, ku muarën tok varfë e fshatarë si robër.” Falë baballarëve dhe dervishëve e ndihmat nga shqiptarët në mërgim, Amerikë dhe Evropë, teqeja u ringrit në vitin 1920.

Kështu më 14-17 janar të vitit 1921, 98 vjet më parë zhvilloi punimet Kongresi i parë bektashian në teqenë e Prishtës të Skraparit. Një nga teqetë më të pasura dhe të rëndësishme në Shqipëri, sidomos për rolin e saj që ka luajtur në fillim të periudhës post-otomane. Morën pjesë baballarët e teqeve të Shqipërisë, intelektual, simpatizant të bektashizmit dhe përfaqësuesi i qeverisë shqiptare Fehim Zavalani. Kongresi aprovoi Statutin Bektashian, i cili u quajt “Lidhja bektashiane” me 28 nene. U zgjodh për herë të parë Këshilli Atnor për drejtimin dhe organizimin e bektashizmit në Shqipëri me qendër në teqenë e Sukës, Përmet. Këshilli Atnor përbëhej nga 7 anëtarë. Neni 1 thuhet: “Për administrimin fetar të teqeve bektashi të Shqipërisë e për të mbajtur rregullin e grupit klerikal bektashian, kongresi i Prishtës i dha fuqi kryesimi “Këshillës Atnore” q’u formua prej Gjysh Ahmet Baba Turani, Gjysh Sulejman Baba Gjirakastra, Ahmet Baba Elbasani, Xhemal Baba Përmeti, Mustafa Baba Frashëri, Kamber Baba Prishta, Hajdar Baba



Turani Korça.” Neni 12 thuhet: “Arka e përgjithshme e bektashive u themelua në këtë Kongres për mbushjen e dëshirës përparimit bektashian.” Rëndësia historike e Kongresit të Parë qëndron edhe në vendimin e tij për përkthimin në gjuhën shqipe të gojëdhënës bektashiane dhe çeljen e shkollës për përgatitjen e klerikëve “Mësimorja bektashiane”.

Është fakt historik se procesi i kombëtarizimit të institucioneve fetare në vitet 1920-1924 erdhi si një proces i nevojshëm dhe në kohën e duhur për forcimin e shtetit shqiptar.

Kongresi i parë bektashian i Prishtës, në Skrapar ishte i veçantë sepse dhe rrethanat historike që po kalonte

vendi ynë, lufta dhe përpjekjet e patriotëve shqiptar për çështjen e kombëtarizimit të institucioneve fetare dhe pavarësimi i plotë i tyre ishte pjesë e procesit historik të konsolidimit të shtetit shqiptar. Sepse kish tendenca për të bërë më të thella dallimet krahinore, që pengonin ndërtimin e institucioneve politike, arsimore e bënin edhe më të lehtë ndërhyrjet e huaja. Duke penguar procesin si brenda dhe jashtë vendit. Prandaj pavarësimi i institucioneve fetare që në fillimet e jetës së pavarur shtetërore ishte një njëje e rëndësishme në kohën dhe vendin e duhur.

Kongresi i parë bektashian i janarit të vitit 1921 pikërisht për këtë ar-



dhe shembull për procesin e vullshëm të sendërtimit të institucioneve të tjera fetare të Shqipërisë së re. Qeveria shqiptare e kohës u tregua shumë e interesuar dhe e mbështeti kongresin e 14 - 17 janarit në teqenë e Prishtës, i cili sanksionoi krijimin e Komunitetit Bektashian Shqiptar.

Prandaj Kongresi i Parë bektashian i Prishtës i janarit 1921 mbetet një trashëgimi i vyer për kombin shqiptar përbën një nga vlerat më të spikatura të bektashizmit dhe kontributeve që ka dhënë. Për bektashianët shqiptarë si në Rilindjen kombëtare dhe gjatë gjithë

sye mbetet një trashëgimi shumë e vlefshme historike për kombin shqiptar, i cili përbën një nga vlerat më të spikatura të bektashizmit

dhe kontributeve që ai ka dhënë në formimin tonë kombëtar'. Statuti bektashian e shpalli të pavarur tarikat bektashian duke u bërë frymëzues

historisë së popullit tonë me devizën „Pa atdhe nuk ka fe“ mbi gjithçka ishte atdheu. Ata e zbatuan me dëlirësi porosinë e kryebektashiut Naim

KUSH ISHTE SALI NJAZI DEDE

Sali Njazi Dede lindi në fshatin Starje të Kolonjës, më 1876 nga ku u largua me familjen në emigrim në Turqi. Atje ku përfundoi dhe gjimnazin. Pa mbushur ende 20 vjeç, ai pati fatin të filloi studimet fetare në teqenë e Haxhi Bektash Veliut... Më pas, iu përkushtuar fesë, gjithmonë duke ndjekur e ndihmuar nga afër çështjen kombëtare shqiptare. Në vitin 1913, në Haxhi Bektash, ai u zgjodh në postin e lartë të Kryegjyshit. Falë nivelit intelektual e fetar, përkushtimit maksimal në udhën e Hakut, shumë shpejt u bë i njohur në rrethin klerikal të Turqisë, Sirisë, Iranit, Irakut, Egjiptit, Rumanisë, Bullgarisë, Hungarisë, Greqisë, Jugosllavisë, Shqipërisë etj. Ai mbahet mend gjithashtu si një organizator dhe drejtues i aftë i Kryegjyshit Botërore të Bektashinjve. Në vitin 1925, Ataturku me ligj, ndaloi dhe mbylli teqetë bektashiane në Turqi. Për këtë shkak, në vitin 1929, Kongresi i tretë bektashian në Korçë vendosi që qendra e Kryegjyshit Bektashiane të vendosej në Shqipëri... Në këtë periudhë, u vendos që Kryegjyshi të ishte sërish Sali Niazi Dede. Ai ka vlera të veçanta, privilegjin dhe respektin e madh për atë që i bëri Shqipërisë dhe shqiptarëve, duke vendosur Kryegjyshit Botërore Bektashiane në Tiranë. Sali Niazi Dede bashkëpunoi me qeverinë e asaj kohe për ligjin mbi fenë, i dha dimensionet të ri bektashizmit në Shqipëri si dhe forcoi marrëdhëniet

e bashkëpunimin me teqetë në rajon dhe në botë. Ai ishte njëkohësisht dhe një krijues i talentuar. Më 28 nëntor të vitit 1941, Sali Njazi Dede për shkak të mos nënshkrimit prej tij të aktit të kapitullimit të Shqipërisë nga Italia fashiste e vranë mizorisht bashkë me dervishin e tij, Azizin, duke mbetur një figurë e lartë e bektashizmit në Shqipëri dhe në botë. Portretin e tij e plotëson dhe fakti se ai, para se të vinte në Shqipëri si Kryegjyshi Botëror, kishte një aktivitet të madh si klerik e atdhetar në Turqi, Greqi, Egjipt e vende të tjera... Si mik i Mustafa Qemal Ataturkut, ka kontribuar dukshëm dhe në pavarësinë e kombit turk. Sipas dokumenteve zyrtare të kohës, „...më 17 dhjetor të vitit 1919, Mustafa Qemal Ataturku viziton teqen e Haxhibektashit ku ishte Sali N. Dedej, ku merr mbështetjen morale dhe materiale të tij dhe Xhemaladin Çelebiut për luftën çlirimtare. Sali Dede u bë aq ndikues në përpjekjet e tij në pavarësinë e kombit turk, sa ishte dhe për prosperitetin e popullit të tij'. Në Shqipëri, veçanërisht pas vitit 1990, ai ka marr vlerësime të shumta zyrtare. Ndër vlerësimet shtetërore dhe nga organizma jo qeveritarë, renditen dhe shpallja 'Dëshmor i Atdheut' si dhe emërtimin e Sali Niazi Dede në emisionin e pullave nga 'Albpost' në ciklin e figurave të shquara për vitin 2001.

Frshëri, i cili theksonte baballarët duhet të kryesojnë me fjalë të shenjta luftën për liri. Varfët (dervishët) të bëhen shokë në gëzime dhe hidhërime. Myhibët, anëtarë spiritual bektashian të mos kursehen nga vdekja për atdhe.

Në fjalën e tij Kryegjyshi Botëror, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj tha midis të tjerave: Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

I nderuar President i Republikës, Shkëlqesia Juaj, Ilir Meta!

Të nderuar vëllezër të mijë, klerikë, myhibë, dhe dashamirës bektashianë!

Motra dhe vëllezër të ardhur nga e gjithë Shqipëria!

Paqja dhe kujdesi i Zotit të Lartë qoftë me ju dhe familjet tuaja për vitin 2019 dhe gjithë jetën! Bekimet dhe lutjet e dervishëve dhe baballarëve bektashianë, ju shoqëroshin në çdo rrahje zemre tuajën!

Së pari, në emrin e miliona besimtarëve anekënd botës, si edhe të juve, të pranishmëve në këtë takim, më lejoni të falënderoj posaçërisht Presidentin e Republikës, Shkëlqesinë e Tij, Ilir Meta, i cili na është gjendur pranë në çdo hap tonin, duke na frymëzuar me fjalën e urtë dhe të ngrohtë, duke na mbështetur në udhëtimin tonë historik si Qendër Botërore Bektashiane.

Faleminderit Shkëlqesi President dhe paçi këmbën e mbarë në Selinë tonë të Shenjtë edhe për këtë vit!

Data e sotme është shumë e rëndësishme jo vetëm për ne në këtë sallë, por të gjithë shqiptarët kudo që janë, brenda apo jashtë trojeve tanë, pasi mbyll vitin jubilar të përkujtimit të heroit dhe krenarisë sonë kombëtare, Gjergj Kastriot Skënderbeut. Një vit i mbushur me evente vlerësues të këtij kalorësi të lirisë, nga Janina deri në Australinë e largët, dëshmoi se shqiptarët janë dhe do të mbeten të vetëdijshëm, se pavarësisht situatave të vështira dhe plot rrebeshe që kemi kaluar dhe kalojmë, raca jonë i falet Zotit, lirisë dhe fateve të atdheut.

Data e sotme mbetet po aq e dashur sidomos për ne bektashinjtë. Më 17 janarin e vitit të largët 1921, në teqenë historike të Prishtës, në praninë e klerikëve më të shquar bektashianë të krejt trevave shqiptare, mbylli punimet e veta, kuvendi i parë i yni, u sendërtua modeli i parë i një bashkëbisedimi dhe bashkëpunimi institucional, bazuar në kodet tona identitare. Në mënyrë të veçantë kur në Turqi dhe krejt viset Aziatike, tarikati bektashian po gjendej nën zemërimin e verbër dhe dënimin kapital



të pakuptimtë, Kongresi i Parë Bektashian, në prehër të maleve të Prishtës, ishte jo vetëm një zjarr i ndezur shprese, por edhe gurë i rëndë themeli në godinën madhështore bektashiane. Njëherazi, ky kongres, u kujtonte dashamirësve tanë anekënd Azisë dhe gjithë botës, se urtësia dhe mendimi i yyer i Haxhi Bektash Veliut, nuk do të vendioseshin dot në kanate arkivash të ftohtë, apo teqe të mbyllura përgjithmonë, por në një realitet të mrekullueshëm që do të shoqëroj breza të tërë në devotshmërinë e tyre ndaj Krijuesit.

Nga lartësia e 98 viteve të shkuar, ne kujtojmë sot me ndjenjat e respektit më të thellë krejt ata klerikë, shtetarë, intelektualë, myhiban dhe dashamirës të tarikati bektashian, të cilët me devotshmërinë dhe përunjësinë e tyre fisnike, vendosën piketat e para nga do të ecte tarikati ynë, duke shmangur meritë dhe keqinterpretimet otomane, për t'u mbështetur fort në identitetin dhe frymën tonë kombëtare. Emra të tillë si: Gjysh Ahmet Turani, gjysh

Sulejman Gjirokastra, Ahmet baba Elbasani, Xhemal baba Përmeti, Mustafa baba Frashëri, Kamber Prishta, baba Ali Tomorri dhe baba Hajdar Qencka, të cilët paskëtaj formuan “Këshillin Atnor”, i bëjnë nder jo vetëm besimit bektashian të fillimshekulit të 20, por sot e kësaj dite kanë hyrë me plot vëmendje në historinë botërore bektashiane.

Data e sotme, ndërkaq zbukurohet edhe me një lajm të gëzuar.

Presidenti i republikës, Shkëlqesia e Tij, Ilir Meta është sot i pranishëm për të lartësuar veprën e pavdekshme të Sali Niazi Dedesë, e këtij kleriku të shkëlqyer, e këtij burri atdhetar, e këtij udhërrëfyesi me frymën e të cilit, patën fatin e madh të rriteshin një brez i tërë klerikësh jo vetëm në trevat shqiptare, por edhe në teqetë që shërbyen plot dinjitet e përkushtim në Kosovë, Maqedoninë Veriore, Greqi, Bullgari etj... Koncepti i qartë i atdhetarisë, rrezatuar në ardhjen në Shqipëri, harmonia me të cilën ai e zhvendosi Qendrën Botërore Bektashiane në Tiranë, si dhe modeli i vijimit të traditave më të vyera qysh nga koha e Haxhi Bektash Veliut, janë shembujt më kuptimplotë prej të cilëve, ne përulemi me respektin e thellë para Sali Niazi Dedeit. Me jetën, me veprën, por edhe me kalimin e tij nga kjo botë, Sali Niazi Dedei, rrëfeu se ishte në nivelin e përgjegjësive që i jepte vetë historia jonë kombëtare dhe shpirtërore.

Duke ju falënderuar edhe një herë të gjithëve për pjesëmarrjen, Zoti u nderoftë dhe u bekoftë!

Paskëtaj Presidenti i Republikës Shkëlqesia e Tij Ilir Meta u ndal në një prej figurave më të shquara të bektashizmit, Sali Niazi Dedej, i cili me jetën



dhe veprën e tij vendosi gurë themeli në godinën madhështore të Selisë së Shenjtë Bektashiane. Ai i dorëzoi Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve titullin e lartë “Nderi i Kombit” për ish Kryegjyshin Botëror Sali Niazi Dedej. Një ekspozitë fotografike e pregatitur nga punonjësit e muzeut të Selisë së Shenjtë posaçërisht për këto dy evente si edhe këngët polifonike të kënduara nga grupi lab “Filladi i Ehli Bejtit” e bënë akoma më mbresëlënëse këtë ditë.

Koresp. “Urtësia”



16 SHKURTI, SI NJË B



Në atë reliev të mrekullueshëm të teqesë së madhe të Elbasanit, midis heshtjes së pishave dhe zhourimës së Shkumbinit, dëgjoj zëra myhibësh e dervishësh, të cilët kanë ardhur në këtë 16 shkurt pranë shenjtërisë së tyrbeve. Këto të bardhat, të shtrenjtat, ftohtësinë e gurëve e kanë fashitur, për t'i lënë vendin ngrohtësisë të zjarreve të shpirttrave. Askush më mirë se këta myhibë, të ardhur nga Tepelena e Mallakastra, Luzi i Kavajës dhe Elbasani, nuk mund të deshifrojnë kodet e vëllazërisë bektashiane. Me duar në gjoks, me trupin e përlur, me fisnikërinë e viteve mbi supë, ata kuvendojnë me mezarët fjalë malli. Fjalë dhimbje e gëzimi si cicërima zogjsh në shkurt. Sepse këta dervishë e baballarë të mezareve, në kohëra të ndryshme, kanë rrëfyer me jetën dhe veprën e tyre se dashuria për Zotin dhe për Haxhi Bektash Veliun, kanë kaluar kurdoherë përmes dashurive të mëdha hyjnore e njerëzore, pikërisht për brezat e artë të besimtarëve.

Sigurisht, më të shumtët e tyre, ndalen në mezarin e baba Sherif Canometajt. Një çerek shekulli më parë, ai mbylli sytë i lumtur sepse mundi të dëgjonte në liri këngën e përhershme të tarikatit bektashian, mundi

të ndjej frymën e bekuar që shpërndahej në shpirtat e besimtarëve. E kishte pritur gjatë atë kohë. Edhe kur e torturonin nëpër qelitë plot lagështi të burgjeve, edhe kur ushtronin mbi atë trup të pakët torturat nga më çnjerëzoret, edhe kur e tallnin dhe e fyenin që të thërriste Zotin për ndihmë. Ai vetëm heshtëte. Heshtëte dhe ndofta në thellësi të shpirtit, lutej për krejt besimtarët, për krejt ata që besonin në dliresinë transhendentale, madje edhe për familjet e këtyre katilëve të ish-sigurimit të shtetit, sepse edhe këta, në këtë botë kishin ardhur si vullnet i Zotit.

Pas ritualeve tradicionale, grupe-grupe, me ngazëllimin e natyrshëm në sy, myhibë dhe dashamirës i drejtohen teqesë së baba

Xhemalit, ku së bashku do të ndajnë emocionet e mevludit, me rastin e 25 vjetorit të kalimit nga kjo jetë të baba Sherif Canometajt. Një përschpirtje ku nuk mungon malli për të larguarin dhe drita e jetës së tij. Gjurmët nëpër të cilat kanë kaluar baballarët tanë, shndërrohen shpesh në piketa të vetëdijes sonë fetare, në sinjale të sigurt, në zhurmën e kohërave plot nevs e krenari vetjake. Sa më shumë dëshira e pasione të frikshme na afron kjo jetë, aq më shumë na mbajnë në "dritë të vërtetë", siç thoshte Naim Frashëri, pikërisht zërat e ngrohtë që vijnë prej mezareve.

Paskëtaj edhe një drekë në respekt të kësaj dite që bashkoi një përvjetor krenar të çeljes së teqesë, me një ditë ku rivjen gati i gjallë, baba Sherifi. Është dervish Admir Selmanaj i cili falënderon të pranishmit, duke u kujtuar atyre se një ndër mrekullitë e takimeve bektashiane, është pikërisht ndarja e gëzimeve me të gjithë familjen e Haxhi Bektash Veliut. Si rrallëkund në ditët e sotme, në tryezat

bektashiane, në biseda e nefese, familja biologjike humbet e tretet në vëllazërinë fetare. Në fjalën e Tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj tha midis të tjerave: ".... Më

BEHAR I PËRJETSHËM

KRYEGJYSHI BOTËROR BEKTASHIAN, HIRËSIA E TIJ HAXHI DEDE EDMOND BRAHIMAJ THA MIDIS TË TJERAVE: ".... Më vjen shumë mirë që Gjyshata e Elbasanit po formon një traditë të vyer në pikëpamje të veprimtarive të tilla me karakter fetar dhe përkujtimor. Me vizitat tona të herë pas hershme në tyrbet ku janë dervishët e baballarët, si dhe në dialogët në heshtje me 'ta, në të vërtetë ne kërkojmë vëmendjen dhe ndihmën e tyre në këto kohëra kaq të vështira që po kalojmë. Ndërkaq, duke shkuar pranë mezareve, duke kundruar jetën dhe veprën e klerikëve bektashianë që e kanë lënë këtë botë, ne kemi gjithashtu mundësinë të flasim me njeri-tjetrin, të japim mesazhe paqe dhe shprese, të urojmë njeri-tjetrin për ditë më të mira. Duke kujtuar sot, ditën e themelimit të teqesë së baba Xhemalit në Elbasan, nuk mund të mos kujtojmë përkushtimin dhe sakrificat e klerikëve të kësaj teqeje, por edhe shpërndarjen e frymës së ngrohtë të dashurisë ndaj Zotit dhe vëllazërisë fetare. Meqenëse në esencë të tarikatit bektashian kanë qenë dhe mbeten të kulluara ndjenjat kombëtare, qytetit kulturdashës të Elbasanit do t'i shtoheshin ndërkaq edhe vlerat më humane njerëzore dhe kombëtare. Emrat e Xhefai Fakri Babait, Mustafa Haki Babait, Hamid Babait, Ali Riza Babait, etj, i bëjmë nder thjeshtë jo vetëm kësaj teqeje dhe tarikatit tonë në Elbasan, por krejt besimit botëror bektashian. Sigurisht në vazhden e frymës që këta baballarë përcollën në teqetë e Elbasanit, ne përkujtuam sot, me ndjenjën e respektit më të thellë, përmes ceremonisë së mevludit, jetën dhe veprën e baba Sherif Canometajt, i cili, për mënyrën se si mbijetoi në ato vite të vështira të regjimit të kaluar, do të mbetet shembull frymëzues për secilin nga ne klerikët, myhibët dhe besimtarët e sotëm. ...



vjen shumë mirë që Gjyshata e Elbasanit po formon një traditë të vyer në pikëpamje të veprimtarive të tilla me karakter fetar dhe përkujtimor. Me vizitat tona të herë pas hershme në tyrbet ku janë dervishët e baballarët, si dhe në dialogët në heshtje me 'ta, në të vërtetë ne kërkojmë vëmendjen dhe ndihmën e tyre në këto kohëra kaq të vështira që po kalojmë. Ndërkaq, duke shkuar pranë mezareve, duke kundruar jetën dhe veprën e klerikëve bektashianë që e kanë lënë këtë botë, ne kemi gjithashtu mundësinë të flasim me njeri-tjetrin, të japim mesazhe paqe dhe shprese, të urojmë njeri-tjetrin për ditë më të mira. Duke kujtuar sot, ditën e themelimit të teqesë së baba Xhemalit në Elbasan, nuk mund të mos kujtojmë përkushtimin dhe sakrificat e klerikëve të kësaj teqeje, por edhe shpërndarjen e frymës së ngrohtë të dashurisë ndaj Zotit dhe vëllazërisë fetare. Meqenëse në esencë të tarikatit bektashian kanë qenë dhe mbeten



BABA FAIK SELMANI, U SHPREH:

“Si në vizitat në mezarët e baballarëve të Elbasanit, ashtu dhe në mevludin në kujtim të baba Sherifit, ne të gjithë së bashku tregojmë jo thjeshtë respektin për të larguarit nga kjo botë, por në radhë të parë për devocionin tonë ndaj Krijuesit, dëshirën e përrjetshme për mos t’i ndarë për asnjë çast, fjalët e bukura nga veprat e bukura. Ne do të kemi kurdoherë nevojë të shkojmë pranë mezareve, sepse atje, së bashku me emrin e të dashurve tanë, jetojmë në të vërtetë historinë bektashiane të Elbasanit, të këtij qyteti me traditë dhe kulturë të ardhur nga shekujt. Përvjetori i sotëm i teqesë së baba Xhemalit, na tregon të gjithëve se besimi bektashian zuri vend në zemrat e elbasanasve, pikërisht për dashurinë dhe vëllazërinë që shpërndante, në agimet e shekullit të 19, për të vijuar më tej me ngjarjet kulmore të viteve për autonomi të kombit tonë. Klerikët, myhibët dhe dashamirësit e teqesë së baba Ismailit, përgjatë rrjedhës së viteve, deri në ditët e sotme, kanë rrëfyer dhe rrëfejnë se dashuria për Zotin në qiell, nuk mund të ndahet asnjëherë nga dashuria për atdheun dhe për familjen. Gjithashtu, 25 vjetori i kalimit nga kjo botë i baba Sherif Canometaj na sjellë pranë të gjithëve, kujtimin e shkëlqyer të atij kleriku, i cili do të mbetet shembulli i përkryer i qëndresës ndaj viteve të ateizmit komunist. Urtësia karakteristike dhe guximi i pashembullt me të cilin baba Sherif Canometaj mundi të përballojë furtunat shtetërore përgjatë viteve 1967-1990, do të mbeten modele të gjalla në mendjet e klerikëve, myhibëve dhe dashamirësve bektashianë për jetë e mot.”

të kulluara ndjenjat kombëtare, qytetit kulturdashës të Elbasanit do t’i shtoheshin ndërkaq edhe vlerat më humane njerëzore dhe kombëtare. Emrat e Xhefai Fakri Babait, Mustafa Haki Babait, Hamid Babait, Ali Riza Babait, etj, i bëjmë nder thjeshtë jo vetëm kësaj teqeje dhe tarikatit tonë në Elbasan, por krejt besimit botëror bektashian. Sigurisht në vazhden e frymës që këta baballarë përcollën në teqetë e Elbasanit, ne përkujtuam sot, me ndjenjën e respektit më të thellë, përmes ceremonisë së mevludit, jetën dhe veprën e baba Sherif Canometaj, i cili, për mënyrën se si mbijetoi në ato vite të vështira të regjimit të kaluar, do të mbetet shembull frymëzues për secilin nga ne klerikët, myhibët dhe besimtarët e sotëm. Me nxitjen e myrshidit tim, dede Reshat Bardhi, në fillim të viteve 90, unë kam biseduar gjatë me baba Sherifin dhe nuk mund të rri pa thënë sot, se lëvizja bektashiane për rindërtim do të ishte e mangët pa urtësinë dhe largpamësinë e baba Sherifit. Prandaj bashkohem sot me të gjithë ju, në këtë ceremonial të mrekullueshëm.

Motra dhe vëllezër! Asnjë veprimtari e jona, qoftë fetare, qoftë kulturore, nuk



Ne do të kemi kurdoherë nevojë të shkojmë pranë mezareve, sepse atje, së bashku me emrin e të dashurve tanë, jetojmë në të vërtetë historinë bektashiane të Elbasanit, të këtij qyteti me traditë dhe kulturë të ardhur nga shekujt. Përvjetori i sotëm i teqesë së baba Xhemalit, na tregon të gjithëve se besimi bektashian zuri vend në zemrat e elbasanasve, pikërisht për dashurinë dhe vëllazërinë që shpërndante, në agimet e shekullit të 19, për të vijuar më tej me ngjarjet kulmore të viteve për autonomi të kombit tonë. Klerikët, myhibët dhe dashamirësit e teqesë së baba Ismailit, përgjatë rrjedhës së viteve, deri në ditët e sotme, kanë rrefyer dhe rrefejnë se dashuria për Zotin në qiell, nuk mund të ndahet asnjëherë nga dashuria për atdheun dhe për familjen. Gjithashtu, 25 vjetori i kalimit nga kjo botë i baba Sherif Canometaj na sjellë pranë të gjithëve, kujtimin e shkëlqyer të atij kleriku, i cili do të mbetet shembulli i përkryer i qëndresës ndaj viteve të ateizmit komunist. Urtësia karakteristike dhe guximi i pashembullt me të cilin baba Sherif Canometaj mundi të përballojë fatet shtetërore përgjatë viteve 1967-1990, do të mbeten modele të gjalla në mendjet e klerikëve, myhibëve dhe dashamirësve bektashianë për jetë e mot.”

mund të jetë qëllim më vete. Simbolika e datave të tilla është shumë më e thellë, në kuptimin e ditëve dhe kohërave që jetojmë. Ne ndjekim me vëmendje zhvillimet e sotme politike, ekonomike, kulturore etj, sepse kemi qenë dhe mbetemi të lidhur ngushtë me çdo hall të Shqipërisë. Ne nuk mund të mbyllim sytë dhe të mos shohim se ç'bëhet me varfërinë shpirtërore dhe lëndore, ç'bëhet me korrupsionin shtetëror, ç'bëhet me rininë që emigron dita-ditës. Pikërisht veprimtari të tilla na shërbejnë të thërrasim shpresën, të forcojmë besimin tek Zoti, të ndihmojmë njeri-tjetrin, të ruajmë tiparet e mrekullueshme të familjes shqiptare.”

Ndërsa në emër të familjes biologjike të baba Sherif Canometajt, përshëndeti me fjalë zemre z. Mustafa Hajdini. Ai solli ndërmend dy-tri episode nga jeta e klerikut të vyer, në të cilat ravijëzohej mendimi i urtë dhe vepra humane e tij, pikërisht në ato ditë e net të vështira për çdo besimtar në Shqipëri. Ndërsa shpesh këto biseda në tavolinë u ndërprejnë prej këngëve, prej atyre drithërimave që iso labe përcjellë në shpirtra. Dhe e ke të vështirë të mendosh se je në ditën e gjashtëmbëdhjetë të shkurtit, se jeton me borën ende të pashkrirë në Labinot e Krastë, ndërsa era e ftohtë vërsillen nëpër degë të zhveshura rrepesh. Mes këtyre klerikëve, të djeshëm dhe të sotëm, mes dritës së bisedave të sinqerta të besimtarëve, ky 16 shkurt, s'është veçse ndjesia e një behari të përvjetshëm.

Më tej, ishte baba Faik Selmani, i cili pasi falënderoi pjesëmarrësit, u shpreh: “Si në vizitat në mezarët e ballarëve të Elbasanit, ashtu dhe në mevludin në kujtim të baba Sherifit, ne të gjithë së bashku tregojmë jo thjeshtë respektin për të larguarit nga kjo botë, por në radhë të parë për devocionin tonë ndaj Krijuesit, dëshirën e përvjetshme për mos t'i ndarë për asnjë çast, fjalët e bukura nga veprat e bukura.

Syrja Xhelaj,
Elbasan, 16 shkurt 2019



Qofsh i paharruar baba Ismaili!



Nga Nuri Çuni

Në rrugën e gjatë për në teqenë e Bllacës udhëtimi me myhibin Mehdi Sula nga Zerqani dhe Skënder Gjoni sekretar i teqesë së Martaneshit kaloi pa u ndjerë. Rrugës biseduam natyrshëm në kujtim të të paharruarit baba Ismail Jangulli. Ai kaloi nga kjo jetë një vit më parë.

Mehdi Sula nga ajo zonë rrëfen: “Fshati i lindjes Godvi është pjesë përbërse e njësisë vendore Zerqan, prefektura Dibër. Ai u rrit në një familje të madhe me tradita bektashiane dhe atdhetare. Patriotizmi i kësaj familje u ngjiz në shekuj ku mori

edhe dritën e besimit bektashian. Stergjyshi i këtij fisi, Selim Jangulli, i nderuar në kullën e lashtë ku jetonte, mori dorë në teqen me emër, atë të Hidër Babait në Kërçovë të Maqedonisë, tek Ismail Babai, rreth vitit 1771. Edhe më pas djemtë e ti, Abazi, Aliu dhe Hyseni bëhen anëtar spiritual në këtë teqe me famë në Ballkan. Kështu brezat vazhduan këtë rrugë bektashiane edhe për gjeneratat e ardhshme, deri në ditët e sotme. Baba Ismail Jangulli është pjesë e këtij brezi besimtarësh të mrekullueshëm. Ai u rrit me edukatën e besimit bektashian që në femijëri. Babai Mehmeti dhe nëna e tij, Hidja e kishin marrë dorë të baba Zeneli në teqen e Bllacës, e cila ndihmoi shumë në edukimin e këtij djaloshi. Ai në rini, vinte në teqen e Zerqanit, të Bulqizës, ngjitej edhe në zabelin e bukur të shenjtëruar dhe të varri i mirë rrëzë tij. Shpesh herë në takimet me të, më tregonte me shumë dashuri, se formimin e tij e ndihmoi përvoja e kushërinjve që ishin myhib, dhe mësoi nga ata. Kur ishte në moshën 23-vjecare në marsin e vitit 1954 merr dorë të baba Xhemal Selca dhe nuk u nda nga aktivitetet që bënin teqet e zonës së Dibrës si ditën e Sulltan Nevruzit, Barjamin e Madh dhe të Vogël, Ashuren etj. Në këto vite punoi mësues në shumë shkolla fillore të fshatrave të Peshkopisë. Më vonë baba Ismaili punon në ndërmarrjen e furnizimit të punëtorëve në Thekër të Martaneshit si magazinier, guzhinier dhe si shitës dyqani. Së fundmi vjen në Bulqizë në punishten e embëlsirave.

Por ligji famëkeq i mbylljes së institucioneve fetare në vitin 1967 nga regjimi komunist, baba Ismail Jangulli e përjetoi këtë fatkeqësi. Momenti me i

dhimbshëm për babain e ardhshëm bektashian ishte kthimi i trupit të zhvarrosur të baba Rushit Tollës në Strikcan pas 37 vitesh. Kufoma e vendosur në dhomën e madhe të Sabri Tollës ishte një zi. I dëshpëruar Ismaili, në prani të shumë banorëve vendas dhe rrethinat e fshatrave të tjerë i kap dorën e baba Rushitit dhe pasi e puth atë me lot në sy e ngre lart duke ju drejtuar të pranishmeve: “Ja kush është Ehli-Bejti që nuk vdes kurrë”. Pjesëmarrësit në këtë rast nuk ishin vetëm besimtarë bektashian, aty nuk mungonin edhe informatorë të sigurimit të shtetit. Baba Ismaili u bë gjah për ta. Në mars të vitit 1976 arrestohet me akuzën “Agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”, dhe dënohet me 10 vjet burg. Para se të merrte denimin, trupi gjykues i drejtohet baba Ismailit: “Shkele këtë fotografi me këmbë dhe do të lirojmë që tani nga salla”. E kishin fjalën për foton e Pirit tonë të ndritur Haxhi Bektash Veliut, që ja kishin marrë si provë në shtëpinë e tij, kur e arrestuan. Por përgjigja e babait tonë të nderuar ishte: “Ma bini ta puth atë, ai më ka denuar mua dhe jo ju”.

Vuajtjen e rëndë fizike e kreu në Spaç të Mirditës ku bëri denimin rreth gjashtë vjetë dhe lirohet në vitin 1981 nga burgu. Familja e tij përjetonte kushte të rënda ekonomike dhe psikologjike për faktin se edhe djalin i madh, ishte vrarë në rrethana shumë të mistershme. Në këto kushte nga Valikardha largohet dhe vendoset në fshatin Dom të rrethit të Matit, ku rinisi një jetë të re plot peripeci e mundim. Kështu me trazira kaloi jetën baba Ismaili deri në vitin 1990.

Me dashuri Skënder Gjoni shprehet se kur erdhi demokracia u



rikthye edhe liria e të besuarit në Zot. Teqeja e Bllacës e shkateruar deri në themel filloi të hedhë shtat falë ndihmës së pakursyer të besimtarëve të krahinave Gryka e Madhe, Bulqiza dhe Gryka e Vogël, ku kanë kontributin e tyre: Baba Halil Curri dhe dervish Maliq Zogu. Mbas kalimit nga jeta të dervish Maliq Zogut, teqen e Bllacës e drejtoi Baba Ismail Jangulli nga 1997 deri në vitin 2018. Ky ishte besnik i dede Reshatit që mori dekretin e drejtimit të teqesë. Si baba i kësaj teqeje të bekuar ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, në ngritjen dhe lartësimin e emrit të mirë të kësaj teqeje. Baba Ismaili nëpërmjet punës së palodhur e ktheu teqen e Bllacës në një parajsë të vogël ku emri i saj i ka kaluar kufinj të shtetërorë. Ne sot përulemi me respekt të thellë për të.

U afruam pa kuptuar në bisedat në kujtim të baba Ismail Jangullit, në teqen e Bllacës. Turmat e besimtarëve i drejtoheshin tyrbes së dervishëve dhe baballarëve në vite, ku prehet edhe baba Ismail

Jangulli, që rrezatoi në jetën e tij vetëm dashuri për njeriun dhe urtësia e tij dha vetëm bashkim dhe vëllazërim. Sot në këtë ditë të bukur shkurti, të gjithë besimtarët e dashamirësit flasin me mirënjohje të veçantë për këtë klerik shëmbullor, që ishte simbol i besimit bektashian. Na presin te teqeja sekretari Bektash Jangulli dhe baba Halil Curri që kanë organizuar këtë veprimtari përkujtimore. Të grumbullur para teqesë besimtarët, dashamirësit takohen përzemërsisht me baba Hysni Shehu, dervish Sali Peti, baba Halil Curri që drejton tani këtë teqe, Ali Shehu i tarikatit kadri. Kryegjyshi Botëror, Haxhi Dede Edmond Brahimaj me këtë rast në fjalën e tij thotë: “Ndjehem i privilegjuar që ndodhem sot këtu, në këtë vend të bekuar të bektashizmit dhe më lejoni t’ju sjell urimet më të mira për familjet tuaja. Zoti i Lartë u pastë në vëmendjen dhe në mbrojtjen e Tij! Kaloi tamam një vit, nga dita kur baba Ismaili u largua nga kjo botë. Kemi një vit që nuk dëgjojmë hapat e tij në



Kaloi tamam një vit, nga dita kur baba Ismaili u largua nga kjo botë. Kemi një vit që nuk dëgjojmë hapat e tij në dhomat e teqesë, që nuk ndeshemi me vështrimin e tij të butë dhe të qeshur, që nuk e dëgjojmë atë zë gurgullues si përrenjtë e këtyre anëve. Këto janë ligje të natyrës, të krijuara prej Zotit të Lartë dhe sigurisht ne u bindemi atyre në këtë botë dhe në tjetrën. Por ne nuk e harruan asnjë çast këtë vit, baba Ismailin. Ne e nderuam atë në bisedat dhe ceremonitë tona, ne pritëm me kënaqësi titullin “Nderi i Kombit” që myrshidin tonë iu akordua nga Presidenti i Republikës, ne erdhëm herë pas here tek mezari i tij, në gjoks të maleve dhe u çmallëm me heshtjen tonë.

dhimbjesh të shndërruara në force, për të ruajtur dhe përcjellë vlerat më të vyera të tarikatit bektashian. Me jetën dhe veprën e baba Ismail Jangullit, lidhet ndërkaq edhe lëvizja e madhe e kësaj treve për t’iu bashkuar ringritjes bektashiane, për të bërë që fjala e urtë e Haxhi Bektash Veliut të rigjejë zemrat e humbura. Të gjithë ne jemi dëshmitarë se si në fillim të viteve ’90, në këtë vend të bekuar, ky klerik e nisi nga e para dhe me dashurinë ndaj besimit dhe besimtarëve, mundi të ringrejë këtë tempull të dashurisë hyjnore dhe asaj njerëzore. Të gjithë ne nuk harrojmë se bujtës në këtë shtëpi të Zotit, ishin jo vetëm dibranët e zerqanasit, por edhe krutanët, tiranasit e deri besimtarët e Vlorës dhe Lazaratit. Ky është bektashizmi, vëllezër e motra, simbol uniteti dhe solidariteti të thellë. Prania e të gjithëve neve, sot në këtë kremtim modern, rrëfen në fund të fundit se baba Ismaili i takon asaj plejade klerikësh që nuk shuhen kurrë. Ata janë kujtuar dhe do të kujtohen në

dhomat e teqesë, që nuk ndeshemi me vështrimin e tij të butë dhe të qeshur, që nuk e dëgjojmë atë zë gurgullues si përrenjtë e këtyre anëve. Këto janë ligje të natyrës, të krijuara prej Zotit të Lartë dhe sigurisht ne u bindemi atyre në këtë botë dhe në tjetrën. Por ne nuk e harruan asnjë çast këtë vit, baba Ismailin. Ne e nderuam atë në bisedat dhe ceremonitë tona, ne pritëm me kënaqësi titullin “Nderi i Kombit” që myrshidin tonë iu akordua nga Presidenti i Republikës, ne erdhëm herë pas here tek mezari i tij, në gjoks të maleve dhe u çmallëm me heshtjen tonë. Ne e kemi mbajtur në zemra gjatë gjithë kësaj kohe baba Ismailin, siç iu mbajmë emrat e shquar të

qindra dervishëve dhe baballarëve të tjerë, të cilët, vunë në themelet e bektashizmit jo thjeshtë këmbënguljen dhe përkushtimin, por krejt jetën e tyre. Baba Ismail Jangulli ishte dhe mbetet modeli i klerikut të përkushtuar. Madje i përkushtuar ndaj Zotit dhe Haxhi Bektash Veliut në kohërat më të vështira që kaluam, në kohërat kur besimi në Zot ndalohej me ligj, me forcë, me ashpërsinë e segmenteve shtetërorë. Ai mbajti të gjallë këtë besim brenda vetes, por ndërkaq nuk u tremb të përcillte atë, tek çdo besimtar shqiptar që ëndërronte të merrte diçka nga drita e Ehli-Bejtit. Qëndresa e tij në burg dhe jashtë burgut, janë në të vërtetë një histori e padiskutueshme

breza, për vetë mënyrën se si e deshën bektashizmin, për heroizmin me të cilin përballuan rreziqet, për frymën e shenjtë që shpërndanë dekadash. Zoti u bekoftë të gjithëve!” Më pas në bisedat me klerikët e pranishëm dhe besimtarët u fol se baba Ismaili do kujtohet dhe nuk do të harrohet kurrë. Bektash Jangulli, thjesht flet, se baba Ismaili këtë teqe jo vetëm që e zbukuroi, por edhe organizoi marrjen e pronave, shtimi i blegtorisë dhënë dhe lopë me një ekonomi ndihmëse e mbajti derën e hapur të kësaj teqeje, çdo ditë priste dhe përcillte besimtarët e ardhur jo vetëm nga Dibra por vinin nga Tirana, Durrësi dhe Vlora, edhe nga Dibra e madhe. Kemi dëshirë në ambjettet e teqesë të kemi një muze të vogël për historikun e shkëlqyer të kësaj teqeje dhe të jetës dhe veprës të baba Ismail Jangullit do të ishte një dritare për të gjithë ne. Me punën e tij një dhomë ishte kthyer në bibliotekën e bektashizmit të kësaj teqeje.

Sulejman Alia shprehet se baba Ismaili respektonte të gjithë pa dallim, besimtarët e zonës së Bulqizës për të mbajtur gjallë traditën bektashiane, dashurinë për Zotin, Muhamed Alin e thosh shpesh duhet të duam Ehli-Bejtin dhe të ndjekim rrugën e tij. Hz. Aliu thoshte: “Gjëja që i vlen vetvetes është dija; ndërsa ajo çka i vlen njerëzimit është mos’harrimi i Zotit.”

Një nga llojet e bujarisë është edhe këshilla e dhënë që ndriçon zemrat dhe shpirtrat me nurin e dijes. Dija është një trashëgimi tepër e rëndësishme. Meditimi është një pasqyrë e tejdukshme. Ajo çka e shton dijen, është të qenit i drejtë. Shkalla më e ulët e dijes është ajo që mbahet në gjuhë. Ndërsa shkalla më e lartë e dijes është ajo që e tregon veten në sjellje dhe veprime. Dija është shoku i veprave të mira. Ai që di, vepron. Prandaj baba Ismaili vepronte dhe bënte çdo vepër të mirë.

Besimtarët e vjetër nga Bllaca dhe Fushë-Bulqiza, Shefki Tafa dhe Skënder Shtino nuk reshtin së foluri për baba Ismailin, se si të afronte me fjalën e ngrohtë dhe dashurinë ndaj Zotit, ai vetëm afronte njerëzit dhe intelektualët i respektonte në veçanti, i dëgjonte dhe i vlerësonte ata. Shpesh e shikoje kur vinte në Fushë-Bulqizë, Sopot, Zerqan e në Grykën e madhe në gjithë fshatrat e Dibrës dhe u qante hallet çdo familje pa dallim. Të jepte kurajo dhe nxiste për punë dhe vepra të mira. Biro!, thoshte: “Jeta mbahet me punë dhe të punojmë këtu në vendin tonë, jo të largohemi jashtë vendit, të mirat i kemi këtu”. I till ishte baba Ismaili. “Qofsh i paharruar!” Uronin gjithë pjesmarrësit në këtë tubim përkujtimor.



Poezi

Baba Mal Tomorri ynë

“Nga Tomorri duket Myzeqeja,
Nga Sazani deti pa kufi...”
P. Marko

Gjithë e ndritura Rilindje,
Me Naimin kryepoet,
I këndoi malit të lartë,
Dhe e bëri më të shenjtë.

Thellë viteve në shekuj,
Njerëzit e kanë në zemër,
Ngjyerë me të kuq kurbani,
Malin tonë që bëri emër.

Katër ditë në fund gushti
Digjet shenjtë këngë e zjarr,
Kurbanët që stolis prushi,
Ilaçi për çdo udhëtar.

Dhe jehona ushton thellë,
Mer luginës tatëpjetë,
Besimtarët bëjnë lutje
T'i dëgjojë dhe Zoti vetë.

Në Kërpicë e në Bogovë,
Ujë të akullt na dhurove,
Guhakun në Çorovodë,
Besojmë se ti e solle.

Gusht më gusht mali mbi male,
Hap zemrën për njerëzinë,
Gjithë ata që kanë halle
Duan përjetë këtu të rrinë.

Pelegrinët puthin majën,
Sikur puthin Perëndinë,
Dush mbi dush i bëjnë shpirtit
Ndahen me Abaz Alinë.

E lanë mbrapa Skraparin,
Nëpër botë u arratisën,
Emrin e shenjtë të Tomorrit,
Thellë shpirtit e stolisën.

Plagët që i hapi koha,
S'ja përishën dot bukurinë,
Ca më lartë i shkoi jehona,
Jo vetëm për Shqipërinë.

Amanet Çukë e Tomorrit,
Për hallet që na ka zënë,
Thuaji Zotit në vesh dy fjalë,
Të shpëtojë dhe vendin tënë.

Nga Luman Caka
Asqeri Koxhaj

Baba Hysen Kukelit

Er`n e lehtë nga trëndafili
E ndjen kush ju viziton,
Baçevan baba Ismaili
E`rn e tyre kundërmon.

Salavat ja Muhamed
Thërras fort Shahun Ali,
Njeri Shah e tjetri mbret
I kërkoj në këtë shtëpi.

Bektash Hajdar JANGULLI

Fole bilbilash

Sekret je i tesavufit
Frymë e ardhë që nga ezeli,
Bajrak i baba Isufit
I dhe drite Hysen Kukelit.

Ish` frymë e Haxhi Hynqarit
Zë i bukur i nefirit,
Shëmbëllen baba Jasharin,
Kurban`e Hazret-i Pirit.

O balli që bën vec dritë
Vetulla jote vet` Alemi,
Je baba Isufi i Dytë
Një t`u shoh, a si të themi.

Është e fshehtë e bektashisë
O drita që s`e sheh syri,
E kane thënë batinitë
Një u sheh vetëm fakiri.

Besn`e e vjetër përsëriti
Ku bënë emër k`to xhanllarë,
Hënë e plotë baba Rushiti
N`dër dërvishë e baballarë.

Kush pastroi grurin nga meli
Emër la në këtë dërgjah,
Nur dhe këngë` baba Zeneli
I dha besë Hazretit Shah

Ai erdh` si valë e detit
Që dëftoi një det të tërë,
Myrshid për dede Ahmetin
Është e shkruar në defter.

Teqeja bektashiane Baba Jashari

Kjo shtëpi e shenjtë
E Haxhi Hynqarit,
Medinë dhe Mekë
Streh e besimtarit.

Teqja bektashiane
Asht` syri i Aliut,
Shpia hane dane
Kudret i Veliut.

Asht ship e viranit
Ku pushon i Miri,
Xhani dhe xhanani
Shpirt i çdo fakiri.

Asht gjemi e jetës
Mu ne mest te detit,

Drit` e se vertetes
Pem e Muhamedit.

Ku femij e tija
Digjen n`at çirak,
Jane simbol i jetes
Drite n`at kerk budak.

Je pema dhe fryti
Pjese per kalender,
Je syri dhe loti
Zgjuar kurdohere.

Bani ymer Zoti
E bekoi Hynqari,
Vend u zgjodh Sopoti
Erdh Ali Jashari.

Kjo kish qenë e thëna
Vresht ku piqet rrushi,
Vjen baba Jashari
Tha baba Isufi.

E kërkon Ballenja
Guva tek te Mirët,
Burr kërkon mejdani
Te par` duan fakirët.

E kërkon ymeti
Shpirti i çdo xhani
Ymer i dha Zoti,
Dhe Ballëm Sulltani.

E do Martaneshi
Kostenja dhe Biza,
Ty ore myrshid
Të kërkon Bulqiza.

Profsh moj Grykë e Madhe

Kullë e fisit Krena
Oxhak përmbi male,
Shendrit ti përhera.

Fal i qofsha Zotit
Dhe shpirtit hyjnor,
Djalit të Sopotit
Engjellit tokësor.

Nefesi dhe malli
Mua peng më ngeli,
Nur` baba Jashari
Dost` baba Hyseni

Teqe e Melanit ndrin

Rrëzë Buretos mbi kodrinë,
Teqe e Melanit ndrinë.
Më 14 nëntor për vit,
Përkujtojmë baba Qamil.

Teqeja mbi kodrinë,
Dita-ditës zë e ndrinë,
qeparisat si gjergjefë
Jeshilojnë rreth e rreth.

Besimtarët nga çdo anë,
Si bletët mbi maxuranë,
Një nga një i falen shenjtit,
Mirënjohje baba shënjtit.

Ky Novruzi një pëllëmbë,
e ngre teqen më këmbë.
Këndon për baba Qamil,
E ka zërin si bilbil.

Dervishi skraparliu,
Këtë vend seç e ndriu,
Punon bashkë me besimtarë
Mbjell ullinj, rrush dhe arrë.

Myhib nga Lazarati,
Libohovë dhe Nepravishtë,
Besimtar dhe patriot,
teqeja kurdoherë është plot.

Zotin e Lartë e duam,
Ndaj i falemi këtij vendi.
Bektashizmin mbajmë në shpirt,
Siç na mban dhe neve shënjti.

Nga Maksim Baze

Në përvjetorin e lindjes së Dede Ahmet Myftarit

Dede Reshat Bardhi për Dede Ahmet Myftarin



Nuk mund të jetonin të dyja së bashku edhe diktatura edhe Zoti. Për t'i shërbyer sa më mirë kolltukëve të tyre, diktatorëve u duhej të ngriheshin në qiell. Po atje lart ka ligje të tjera. Prandaj këtu poshtë kish nisur shkatërrimi. Baba

Selim Kaliçani ka qenë gjithashtu ndër të parët, që na erdhi në Drizar. Ai kishte një optimizëm karakteristik. Na mbante me gajret. Bile na jepte krahë për të kundërshtuar çdo lëvizje që shkonte kundër erqaneve të bektashizmit. Në shkurtin e vitit 1966 erdhi tek ne i mërzhitur. Na dha lajmin e

hidhur që Këshilli i Përgjithshëm Bektashian, ish mbledhur dhe kish thënë që shumë teqeve t'u vihej kyçi, sepse gjoja nuk shkonin më njerëz. Kuptohet këto vendime merreshin në zyrat e Enver Hoxhës. Por shiteshin sikur ishin mendime të baballarëve. U morën vendime për teqetë e jugut në fillim. Do mbyllej teqeja e Melanit dhe e Zallit. Ishin bërë gati të shkonte ushtria. Më përpara akoma, ushtria kishte hyrë pa pyetur në teqenë e Frashërit duke i lënë baba Mehmet Zykës, vetëm një dhomë të vogël për të fjetur. Po u vihej kyçi teqeve në Përmet. Tepelenë dhe Kolonjë. Ajo që na dhimbsej më shumë ishte se kyçin ja vinin vetë baballarët. me urdhër nga partia. Baba Selimi na siguroi se çfarëdo të ndodhte, ai nuk

do të ndalej për ku ishte nisur. Dhe sa më shumë dervishë e baballarë të tillë të vendosur të ishim, aq më lehtë do ta kishim. Myrshidi im e ndjente mënxyrën e afërme.

I dërguam dikur haber baba Selmanit të Kapajt dhe ky ndonëse i ligur nga sëmundja erdhi. Na tregoi se disa mësues shkollë në Kapaj dhe Greshicë, bënë propagandë që nxënësit të bënë shfaqje estrade, ku të talleshin me dervishët e teqesë. Ardhja e fëmijëve në oborr të teqesë, po shuhej dalëngadalë. Natën e parë, ne bëmë bukën dhe u ulëm në sofër të tre së bashku. Sofra ishte plot, por muhabeti nuk ecte. Unë doja të ndizja ndonjë

urë bisede por dy baballarët ishin shumë larg. Gjellët mbetën në sofër. Mbeti edhe një gjel që e kish sjellë me vete, baba Selmani. Zoti i ruan shenjtorët e tij nga syri, ka thënë diku Haxhi Bektashi. Ai i bën ata kurdoherë të ngopur. Kështu që nuk i njohin dot ata, që janë përlyer keq me këtë botë. Ndërsa brendësinë e tyre e ka ndriçuar me bukurinë e lartësisimit shpirtëror. Unë i shtrova baba Selmanit të flinte dhe tek e mbuloja dëgjova zërin e tij lutës: "Ja Haxhi Bektash, mos më zgjo nga gjumi. Si shoh dot shejtanët!" Ai donte të ikte nga kjo jetë, përpara se të shihte me sy rrënimin e teqeve. Pak muaj më pas, mbylli sytë përgjithmonë. Në përcjelljen e tij, m'u kujtuan fjalët përpara se ta zinte gjumi, në Drizar.

Shenjtërinë e kish marrë me vehte.

Një tjetër sinjal na erdhi nga oficeri i sigurimit që mbulonte zonën tonë. Ai ishte i krishterë dhe vinte rrallë në teqe. Por sa herë që vinte, ne nuk e linim të ikte pa bukë, sipas zakonit të vjetër të teqesë. Një ditë, kur kisha vajtur në Fratar për të blerë disa dërrasa, m'u afrua pranë dhe kur u sigurova se s'kish njeri përreth, më tha: "Dervish, dërrasa ç'o sa të duash në teqe, po libra s'dua unë atje. Po ju pashë libra e kini keq!" Sapo shkarkova dërrasat nga kali, i dhashë haberin myrshidit tim. Po atë natë, kur Hasan Kalemi po largohej nga teqeja, ne i dhamë kalin tonë me dy hejbe. Brenda tyre, futëm të gjithë librat që kishim aty në arabisht dhe shqip. Ata libra na

patën shoqëruar në tërë ato vite. I lexonim dhe rilexonim. Herë - herë myrshidi im, shpjegonte dhe unë mbaja shënime në fletoren time. Për mua, më mirë të jepnim dhen e dhi, tokë apo para, vetëm të mbanim ata libra. Të mbanim ato fjalë të mençura të Pirit tonë, vjershat e dervishëve dhe baballarëve.

Por me Hasan Kalemin na doli një problem tjetër. Ai dihej nga të gjithë, që ishte njeriu më i afërt i teqesë së Drizarit. Dihej gjithashtu që ne kishim dy sëndyqe me libra bektashianë. Nëse kontrollonin në teqe dhe nuk gjenin gjë, mendja do t'u shkonte në shtëpinë e Hasan Kalemit. Atëherë vendosëm që librat tanë,

Unë mendoj se viti 1967, nuk mund të ketë sjellë çudi të mëdha edhe për shërbëtorët e besimeve të tjerë në Shqipëri. Por thika në palcë na hynte ne, bektashinje. Për vetë kodin tonë zakonor, ne nuk kishim krijuar familje. Ne nuk kishim marrë zanate. Ne nuk kishim asnjë kasolle ku të fusnim kokën, sepse jetën dhe pasuritë i kishim dhënë në lulëzim të teqeve. Kështu e pritëm me qetësi, fjalën e një myhibi të përkushtuar Hysen Jaçes. Ky na bëri me dije se organizata e partisë në Drizar ishte mbledhur, për punën e fesë dhe kishin vendosur për largimin tonë nga teqeja dhe kthimin e ndërtesave të saj në depo të kooperativës.



Hasani të mos i fuste në shtëpi, por t'i mbante prapa tyre, aty ku ishin dy kasolle dhe një mullarë bari. Që mos të zbuloheshin rastësisht librat, ne i falëm Hasanit një lopë nga të teqesë si edhe dy mullarë bari. Në njërin prej tyre, Hasani vendosi çantat me libra. Pas kësaj ne u lehtësuan. Të paktën kishim në ruajtje atë thesar të rrallë. Librat e shenjtorëve bektashian në çmendurinë e vitit 1967, u dogjën apo u zhdukën me mijëra.

Ne ende shpresonim, ende luteshim. Por, në janarin e vitit 1967, nga Tirana vjen urdhri që të bëhej inventarizimi i plotë i objekteve dhe mallrave të teqesë. Në momentin që do të caktonte partia, këto pasuri do t'i dorëzoheshin me proces verbal të rregullt, drejtuesve të pushtetit popullor. Asnjë klerik bektashian nuk kishte të drejtë të vinte dorë mbi këtë pasuri. Gjëma isha shpallur. Baba Jonuzi i Greshicës, kish shkuar në Selinë e Shenjtë, për të pyetur se ç' është kjo marrëzi, por atje e kishin tallur. Ai erdhi me një frymë tek ne. Kishte merak se mos nuk i dorëzonim gjërat në rregull dhe në atë fatunë që kishte nisur kundër besimit. Na kalbnin nëpër burgje. Në ato orë të vështira, muhabeti u mbyll mbi këtë fatkeqësi, jo vetëm

për bektashinjtë por gjithë besimtarët shqiptarë, myslimanë dhe të krishterë. Më tej, myrshidi im duke kuptuar me qartësi se çfarë po ndodhte, na bëri me dije se mund të shkonte në Vlorë tek të afërmit e vet. Po ashtu edhe baba Jonuzi, kish menduar të rrinte tok me nipin.

Në muhabet e sipër, për të sjellë ndërmend se dervishët dhe baballarët kanë patur si yje ndriçues në rrugën e gjatë, porosinë e shenjtorëve, baba Jonuzi tregoi për çastet e fundit të Imam Xhafer Sadikut, paqja qoftë mbi Të. Kur e ndjeu se do kalonte nga kjo jetë, Imami ynë la disa amanete. Midis tyre ishte që, të shpërblenin me disa dinarë, një të afërmin e familjes, i cili nuk ishte në gjendje të mirë. Të gjithë u çuditën për këtë amanet, sepse personi që duhej shpërblyer, pak kohë më parë kish dashur të vriste Imamin. Këtë çudi nuk e mbajti dot një nga shërbyeset e shtëpisë, Salimja, e cila e pyeti të zotin e saj. Ndërsa Imam Xhafer Sadiku, paqja qoftë mbi Të, me shpirtin që po i dilte iu përgjigj: "O Salime! Allahu ka krijuar xhenetin dhe aromën e tij e ka bërë aq të këndshme, sa të të kënaqë shpirtin në distancën e dy mijë vjetëve. Por këtë aromë

nuk do ta shijoj dot, ai që është sjellë keq me prindërit dhe me të afërmit e familjes".

Nuk ishte si një vetëtimë në qiell të pastër. E kishim ndjerë qysh kur na larguan nga Tirana. Myrshidi im, pati lajmëruar të gjithë ata baballarë, tek të cilët kishte besim. Unë mendoj se viti 1967, nuk mund të ketë sjellë çudi të mëdha edhe për shërbëtorët e besimeve të tjerë në Shqipëri. Por thika në palcë na hynte ne, bektashinjtë. Për vetë kodin tonë zakonor, ne nuk kishim krijuar familje. Ne nuk kishim marrë zanate. Ne nuk kishim asnjë kasolle ku të fusnim kokën, sepse jetën dhe pasuritë i kishim dhënë në lulëzim të teqeve. Kështu e pritëm me qetësi, fjalën e një myhibi të përkushtuar Hysen Jaçes. Ky na bëri me dije se organizata e partisë në Drizar ishte mbledhur, për punën e fesë dhe kishin vendosur për largimin tonë nga teqeja dhe kthimin e ndërtesave të saj në depo të kooperativës.

Myrshidi im i tha Hysenit, që të shkonte tek sekretari i byrosë së partisë të kooperativës dhe t'i thoshte që teqenë le ta mermin. Por të linin vetëm një dhomë për babanë dhe dervishin. Fundja ne mund të punonim edhe në kooperativë, por dhomën të na e linin se s'kishim as shtëpi dhe as katandi.

Pas dy ditësh, Hysen Jaçja erdhi me sytë përdhe. Ne e kuptuam pa folur. Ai na tregoi se në këtë vale, duheshin bërë llogaritë me tru dhe jo me shpirt. Në organizatën e partisë, ç'është e vërteta ishin ngritur një dy të rinj dhe kishin propozuar që largimi i klerikëve bektashian, të shoqërohej me një ceremoni të demaskimit të tyre. Por këtë, nuk e kish pranuar me



të vjetërit. Ndonëse të gënjyer nga komunizimi, disa myhib ishin ngritur dhe kishin kundërshtuar me forcë këtë ide. Bile një prej vendimeve që muar në fund, ishte që disa komunistë të shkonin në teqe dhe të njoftonin me urtësi dhe njerëzillëk babanë dhe dervishin që të largoheshin prej andej. Ajo që më ka bërë përshtypje ato ditë dhe netë, ishte pikërisht dhimbja e myhibëve tanë. Tashmë pa u druajtur ata vinin, bisedonin, na ndihmonin të bënim gati plaçkat, na bënin edhe dhurata. Hasan Kalemi me atë korrektesën e vet, nxori një letër ku kishte emrat e disa drizarasve që ne, u kishim dhënë lekë borxh, apo kishim bagëti. Ai na kërkoi leje, që të shkonte shtëpi më shtëpi dhe t'ua kërkonte. Por dedei nuk deshi: "Kur ti kenë le t'i japin" tha. "Po ku do t'u gjejnë? - pyeti Hasani. "Do na gjejnë, tha myrshidi im, qoftë në gjallje, qoftë në vdekje". Vite më pas kur myrshidi ndërroi jetë, midis tufave me lule, në shenjë respekti, ishin edhe dy tufa prej drizarasve.

Plagë e hapur, gjatë gjithë këtyre vjetëve. Plagë që nuk m'u mbyll kurrë në shpirt. Thonë se koha mbyll çdo plagë. Tek dervishët

bektashian ka përjashtim. Sa më tepër largohem në kohë nga kjo ditë, aq më e madhe më bëhet dhimbja. Atë mëngjes shkurtitë vitit 1967, na kishin ardhur dy - tri myhib nga Vlora dhe Luzi i Kavajës. Këta do na shoqëronin, myrshidin tim për në Vlorë, mua për në Tiranë. Dy ditë më parë, disa dashamirës nga Tirana kishin ardhur dhe ne u patëm dhënë disa prodhime bujqësore. Ata i shitën dhe na kthyen lekët. Tërë natën nuk fjetëm fare. Myrshidi më dha porosinë e fundit dhe bekimet e thella. Sipas fjalës, një përfaqësi prej gjashtë- shtatë vetësh nga Drizari, erdhën në oborrin e teqesë për ta marrë atë në dorëzim. Rreth një kilometër larg tyre, tek shtegu i arës së teqes, ishin mbledhur dhe prisnin në heshtje dy- tre qind të rinj dhe të reja. Këta prisnin largimin tone, për të filluar nga shkatërrimi i tyrbes ku ishin eshtrat e baballarëve që kishin shërbyer në Drizar. Më i moshuari prej përfaqësisë, mori kafën në dorë dhe me gjysëm zëri i tha dedeit se ishin të detyruar të bënin çfarë thotë partia. Ai na uroi ne të dyve, që të fillonin një jetë të re dhe të krijonin familje. Myrshidi

nuk foli. Po ti dervish ç'thua? m'u drejtua mua, një nga përfaqësuesit e rinisë. Unë iu përgjigja shkurt se dervishët e kanë familjen e tyre, atë të mejdanit. Më tepër s'mund të flisja. Po më mposhtte dhimbja.

Myrshidi im, pasi u pi kafeja, u kërkoi përfaqësuesve të pushtetit që, nëse do t'i prishnin mezarët e baballarëve, eshtrat e tyre të paktën t'i vendosnin në varrezat e fshatit. Me muret le të bënin çfarë të donin. Nuk muarëm përgjigje dhe me kafshët e ngarkuara, lamë oborrin e teqesë. Kur kishim bërë dy- tri qind hapa u kthyem pas. Bëmë lutje dhe u futëm në rrugën e përroit, për mos të parë më se çfarë do të bëhej.

“Në urën e Povlës, ne do të ndaheshim. Dedei për në Vlorë tek një i afërt i tij, Rasimi. Unë për në Tiranë. Ai nuk i mbajti lotët. U mbështet në gjoksin tim për disa minuta dhe qau. Nuk kish qënë kështu. Kish qënë i fortë. Kur shkua në Drizar, nëntë vjet më parë, kish sy dhe mjekër të zezë. Tani sytë nuk kishin më dritë. Mjekra i qe zbardhur fare. Dhe ishte vetëm pesëdhjetë vjeç. Kishte kaluar tërë ato dallgë në jetë dhe kish qëndruar. Kësaj dallge nuk po i qëndronte dot. Të vetmet fjalë që nxorri ishin që të ruaja veten. Dhe duke lotuar, pëshpëriti hadithin e famshëm profetik: “O Allah i Lartë! Mos na ler vetëm. Mos na dërigo tek të liqtë, që të shuhemi fare!”

Tiranë, Nëntor - Dhjetor 2007

Dëshmi krenarie për brezat



Nga Nuri Çuni

shënjtë Ali Riza Dede, ka lindur në qytetin e Krujës më 18 tetor të vitit 1876, prej një familjeje me traditë bektashiane, në banesat brenda mjedisit të kalasë së Krujës. Qysh në moshë të vogël prindërit e çonin shpesh në teqenë e Dollmës, të Shememi Babait dhe teqetë e tjera në qytetin e lindjes. I edukuar me këtë besim të mrekullueshëm bektashian, ai shikonte dritën dhe dashurinë ndaj Zotit, ku mbresa të veçanta lanë vizitat e shpeshta në teqen e Sarisalltikut në malin e

Krujës, që e bënte më këmbë çdo javë me pridërit e tij. Një traditë kjo që e bënin gjithë besimtarët e Krujës në Guvën e Shenjtë. Mbas vdekjes së babait, Hasanit, i ra barra për të mbajtur familjen e tij, sepse Rizai ishte më i madhi fëmijve. Në moshën 14 vjeçare punoi hyzmeqar në Krujë, Shijak në punë të ndryshme. Në moshën 18 vjeçare shkon në teqen e Shememi Baba në Fushë-Krujë dhe mer dorë të babai i teqesë, bëhet anëtarë spiritual, myhib, dhe me kalimin e kohës duke marë njohuri dhe ndjekur rregullat dhe normat e tarikatit bektashian, iu shtua më

shumë dashuria për tu bërë klerik.

Me lejën e familjes dhe të afërmeve të tij, konsakrohet dervish nga baba Haxhi Subashi i teqesë së Shememi Babait. Por ai kish dëshirë për të ngritur njohuritë e tij për bektashizmin dhe kërkonte vazhdimisht të vazhdonte shkollë jashtë vendit në Haxhi Bektash. Për këtë iu krijua mundësia, aty rreth viteve 1902 të shkante së bashku me dervish Xhaferin (u bë edhe ky, Kryegjysh, në vitin 1944) nga Gjirokastra në Haxhi Bektash në Turqi. Këtu për disa vite, dervish Rizai bëri shkollë dhe mori njohurit e nevojshme për udhën bektashiane. Por, gjatë kësaj

periudhe kreu udhëtimin- obligim në Mekë, vizitoi varrin e Profetit Muhamed, të Imam Aliut në Nexhef dhe varret e dëshmorëve të Qerbelasë. Më tej bëri dhe shumë vizita në Irak e vende të tjera të Lindjes. Për disa vite me radhe bëri shkollën teologjike në qytetin e Damaskut, në Siri duke shtuar më tej njohuritë fetare teologjike dhe mësimet për mjekësinë. Rreth viteve 1914 kthehet në Shqipëri, në qytetin e lindjes, Krujë. Por situata e vështirë dhe lufta e verbër fetarisht e rebelimit të Haxhi Qamilit, bënë që dervish Rizai së bashku me dervish Asllan Trepshin të shkojnë për të shërbyer në teqenë e Martaneshit për disa vite me radhë. Ata lanë gjurmë shumë të mira në popullsinë e kësaj krahine me tradita në besim e dashuri në Zot. Vençanërisht i vyeri baba Aliu komunikonte me besimtarët dhe shpesh shkonte te vendi i shenjtë në Ballenjë të Martaneshit, te guva e Ballëm Sullanit me histori të madhe. Këtu, në Kaptinën e Martaneshit bëhej pelegrinazh nga gjithë zona dhe Dibra.

Në vitin 1918 thirret nga baba Hamidi i teqesë "Pusi që lahet vetë" në Elbasan, ku plotësoi përvojën nën kujdesin e veçantë të tij. Mbas vdekjes së baba Hamidit, zë postin e tij sipas rregullave bektashiane. Këtu punoi me përkushtim për 23 vite me radhë, deri në vitin 1941. Nga viti në vit u rrit autoriteti i tij dhe fitoi një respekt të veçantë, jo vetëm për besimtarët bektashian, por edhe gjithë banorët e Elbasanit dhe krahinat rreth saj. Ai me punën shumë vjeçare dhe predikimin fetar kish fituar aftësi, dhunti mistike të cilat i vuri në shërbim të besimtarëve dhe dashamirësve të krahinës së Elbasanit, u bë një personalitet i njohur i bektashizmit.

Përgatiti shumë myhibë, dervish, ai ndihmoi edhe dervish Ahmet Myftar Ahmataj për kulturën dhe ritet fetare të besimit bektashian, e pa tek ai, dashurinë, përkushtimin për familjen e Ehli-Bejtit, që ishte dervish në kohën e tij. Teqen e ktheu në një vend të bukur me kopsht, bimë e lule, sa vizitohej nga gjithë qytetarët e Elbasanit, e cila u kthye në një vatër edukimi e streh e të varfëve, e cila rrezatonte mirësi, dashuri dhe vëllazëri për të gjithë.

Mbasi u vra i ndjeri Kryegjysh, Sali Niazi Dede, më 28 nëndor të vitit 1941, në Tiranë, këshilli klerikal e zgjodhi baba Rizanë, Kryegjysh Botëror të Bektashinjve, më 10 janar të vitit 1942. Si Kryegjysh së pari përfundoi godinën e madhe që ngriti Sali Niazi Dede dhe organizoi punën brenda e jashtë vendit në forcimin e bektashizmit. Në këtë periudhë komunikoi, bashkëpunoi, e bëri lidhje me disa teqe në Ballkan dhe më gjërë. Dokumentat arkivore flasin për bashkëpunimin me komunitet bektashianë në rajon dhe në botë. Sigurisht në vitet 1942-1944, për shkak të rrjedhave të vrullshme të Luftës së Dytë Botërore, ashtu si çdo besim tjetër në Shqipëri, edhe bektashizmi do të gjendej përpara dilemave të mëdha. Sepse teqetë, gëlonin nga myhibë dhe dashamirës, të cilët i mbanin sytë nga myrshidët e tyre. Pati teqe bektashiane si ajo e Rabijes në Tepelenë që u shndërrua në Qerbela nga gjaku i klerikëve dhe myhibëve, në luftë me okupatorin fashist italian, por pati edhe teqe si ajo e Zallit në Gjirokastrë, e cila nuk i hapi dyert për komunizmin, duke ditur se idetë e tij, vinin nga Rusia e largët, e cila askurrë nuk na kish dashur. Pra realisht, dervishët dhe baballarët bektashianë në më të shumtën e rasteve, u udhëhoqën

jo nga ideologjitë, por nga deviza e shenjtë për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e atdheut.

Pikërisht në këto momente me përgjegjësi kaq të madhe historike, Dede Ali Rizai u tregua kurajoz dhe largpamës. Ai me fjalë dhe vepra bëri thirrje që çdo besimtar bektashian t'u dilte zotë fateve të kombit, sepse edhe vet Piri ynë, Haxhi Bektash Veliu, e quante detyrim që vatani të mbrohej me pushkë nga të huajt. Edhe pse pati ndërhyrje nga instancat shtetërore të kohës për t'iu bashkuar pushtetit në vendimet e marra, Dede Ali Rizai e ruajti të shenjtë traditën bektashiane dhe eci në gjurmët e ndritura të Sali Niazi Dedit. Ndërroi jetë më 22 shkurt të vitit 1944 në spitalin e Tiranës, por vdekja e tij, mbeti një mister sot e kësaj dite. Me rrëzimin e komunizmit në Shqipëri u sollën eshtrat e tij në qershor të vitit 1993 nga varreza publike Tiranë dhe sot prehen në tyrbet e dedelerëve në Kryegjyshatën Botërore Bektashiane.

Është dekoruar me titullin e lartë nga Presidenti i Republikës në vitin 1993, me Urdhrin për veprimtari patriotike të Klasit I-rë. Gjithashtu në vitin 2017 u dekorua nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë "Nderi i kombit". Përkujtimi i tij jubileun e 75 vjetorit të kalimit nga jeta, veprimtaria dhe kontributi i tij është një mesazh me vlera të mëdha për bektashizmin në Shqipëri dhe në botë. Ishte dhe mbeti i palodhur në rrugën e Hakut. Zëri i tij, fryma e tij, gjithë jeta e tij, vjen sot në brezat e klerikëve dhe besimtarëve bektashianë si një ujëvarë malli të përjetshëm. Sakrificat e tij mbeten dëshmi për brezat.

Duajje me frymën Tënde!

Nga Ganireva Pashajeva

Ka qënë një mëngjes maji i vitit 2009, kur disa miq të mi, në qendrën kulturore turke në Tiranë, më telefonuan në hotel dhe më dhanë lajmin e gëzuar: lideri botëror i bektashinjve, Reshat Bardhi do të më priste. U emocionova. Diçka kisha lexuar për bektashizmin në Shqipëri dhe duke dashur ta interferoj me kodet tona doktrinare në Azerbajxhan, e pashë se nuk e kisha të lehtë. U përpoqa të merrja edhe njëllorj informacioni, me anë të bisedave me miqtë e mi turq, por sidoqoftë mendimet më davaritëshin nëpër qiellin si qelq të Tiranës. Ne, ndjekësit e Ehli-Bejtit në Azerbajxhan, kemi preferuar gjithmonë takimet me sivëllezërit tanë në dy aspekte. Aspekti i parë është ai i që ne, sikundër çdo musliman që e beson njëjshmërinë hyjnore, në çdo rrethanë dhe në çdo moment është i vetëdijshëm se nuk mundet të jetë i mjaftueshëm për vetveten. Ne për Zotin tonë të përhershëm, njohim vetëm Allahun e Lartë, cilësitë e të cilit, nuk ka peshore ndjenjash që t'i peshojnë. Aspekti i dytë lidhet me thellësinë e ndjenjave tona, që

afrohen dhe kërkojnë dijen. Ashtu sikundër shekuj më parë, imamët e dymbëdhjetë e vizatuan me veprat e tyre dhe me fjalët e tyre shenjtërinë e dijes, për ne është e qartë si drita e diellit se besimi fillon me dije. A nuk është urdhri "lexo" fjala e parë e ajetit të parë, që ka zbritur prej Kuranit Qerim, shekuj më parë?

Lideri botëror bektashian i kishte sytë shumë më të qeshur se mëngjesi i asaj dite, në kryeqytetin shqiptar. Që në minutat e para që u takuam unë gjeta paralelet e famshëm shpirtëror midis Shqipërisë dhe Azerbajxhanit, paralele të cilët udhëtonin pranë e pranë, në prirjen e tyre drejt shenjtërisë së skajshme njerëzore.

Shoqëruesit e mi, më paraqitën përpara tij, si politikane e forcave përparimtare, si deputete në parlamentin e Azerbajxhanit, si përfaqësuese e një fryme të re në politikën e vendeve të Evropës Lindore. Dhe tamam pas kësaj ekspozije disi bezdisëse, që të duket se nuk të jep shanse për bisedë të lirë, kur secili prej nesh mund të priste pyetje të sferës politike, baba Reshat Bardhi m'u drejtua mua duke më pyetur: "Ç'njerëz ke në shtëpi?" Unë u çlirova plotësisht, Duke qënë e vëmendshme ndaj traditës sufiste, nxitova t'i flisja për veten, prindërit dhe gjyshërit e




Mësimi që mora ishte befasues, ose i thënë ndryshe shumë i qartë jo vetëm në kontekstin ballkanik por edhe për bashkëbesimtarët e mi në Azerbajxhan. Lideri bektashian më spjegoi se në haxhin e lamtumirës, i Dërguari i Allahut, shpalli midis shumë xhevahireve të tjerë edhe dy trashëgimitë shpirtërore më të çmuara. Kur dikush nga turma e pyeti se kush ishin këta dy trashëgimi, Ai u përgjigj: “E para dhe më e rëndësishmja është libri i Allahut. Ky libër qëndron në një rënë anë në dorën tuaj dhe në anën tjetër në dorën e Zotit. Shtrëngoni fort këtë libër, që të ecni vetëm në rrugë të drejtë. Dhe trashëgimia e dytë e çmuar është familja ime. Zoti i Mëshirshëm më lajmëroi dhe më shpalli se këto dy pasuri nuk ndahen nga njëra – tjetra, derisa të paraqiteni përpara meje në ditën e kijametit. Pastaj Profeti Muhamed (aleqym selam) kapi dorën e Imam Aliut e ngriti lart dhe tha: O popull! Cilët nga besimtarët meritojnë më shumë sa sa ky? O Zot! kije mik çdo besimtar që e mban për mik Aliun dhe bëhu armik, për këdo që kërkon të keqen e Aliut. Duaje me frymën tënde çdo njeri që do Aliun, ndihmoje me frymën tënde çdo njeri që ndihmon Aliun dhe braktise me frymën tënde çdo njeri që braktis Aliun!”

mi, duke zbuluar jo pa ankth edhe emrat e tyre që vërtiteshin rreth: Ali, Hasan, Hysen dhe Fatime.

Pasi më dëgjoi me vëmendje, lideri botëror bektashian, m’u kthye duke më thënë: “Ej, po ti qenke goca jonë! Pse duhet me kërkuar ndihmë nga turqit ti, për me ardhë në derë të shtëpisë tënde?” Sa hap e mbyll sytë, gjaku m’u duk se filloi të qarkullonte shumë më mirë se më parë, në damarët e mi. Më erdhën ndërmend vajtjet e mija nëpër muhabetete teqesh, në fëmijëri dhe dashuria e prindërve të mi, për Imam Aliun, të cilin ndonëse në vitet e diktaturës donin ta errësonin, nuk mundën dot, në asnjë rast të bënin diçka të tillë. Unë, vetëm sa hapa siparin e një shfaqjeje dashurie për Imam Aliun dhe doja të kisha një ide sa më të qartë për këtë prijës fetar, por gjithmonë sipas përfytyrimit dhe koncepteve të bektashinjve të Europës Juglindore.

Mësimi që mora ishte befasues, ose i thënë ndryshe shumë i qartë jo vetëm në kontekstin ballkanik por edhe për bashkëbesimtarët e mi në Azerbajxhan. Lideri bektashian më spjegoi se në haxhin e lamtumirës, i Dërguari i Allahut, shpalli midis shumë xhevahireve të tjerë edhe dy trashëgimitë shpirtërore më të çmuara. Kur dikush nga turma e pyeti se kush ishin këta dy trashëgimi, Ai u përgjigj: “E para dhe më e rëndësishmja është libri i Allahut. Ky libër qëndron në një rënë anë në dorën tuaj dhe në anën tjetër në dorën e Zotit. Shtrëngoni fort këtë libër, që të ecni vetëm në rrugë të drejtë. Dhe trashëgimia e dytë e çmuar është familja ime. Zoti i Mëshirshëm më lajmëroi dhe



më shpalli se këto dy pasuri nuk ndahen nga njëra – tjetra, derisa të paraqiteni përpara meje në ditën e kijametit. Pastaj Profeti Muhamed (aleqym selam) kapi dorën e Imam Aliut e ngriti lart dhe tha: O popull! Cilët nga besimtarët meritojnë më shumë sa sa ky? O Zot! kije mik çdo besimtar që e mban për mik Aliun dhe bëhu armik, për këdo që kërkon të keqen e Aliut. Duaje me frymën tënde çdo njeri që do Aliun, ndihmoje me frymën tënde çdo njeri që ndihmon Aliun dhe braktise me frymën tënde çdo njeri që braktis Aliun!”

Mua më pëlqeu së tepërmi ky formulim, i cili ndonëse ka kaluar nëpër disa etapa kohore dhe në versione të ndryshme, të paktën në pikëpamje të trajtave gjuhësore është ruajtur pothuajse i paprekur në formën e vet. Tymnajat e shekujve, nuk kanë mundur të prekin autencitetin gjenetik të doktrinave. Dhe unë më shumë për t’i treguar këtij lideri të gjerë nga shpirti se isha në të njëjtën gjatësi vale, emocioni dhe dije me të, i kujtova se sipas trashëgimisë sonë, në vendet myslimane të ish-Bashkimit Sovjetik, thuhej dhe besohej se tek Imam Aliu gjendeshin

edhe dijet me fjalë edhe dijet me heshtje. Prandaj në personalitetin e tij bashkohen e bëhen njësh, dija e profetëve dhe ajo e shenjtorëve, të cilat në çdo rast kur bashkudhëtojnë pasurojnë njëra- tjetrën. Më kujtohet se ndërsa unë flisja rusisht, sekretari i liderit bektashian, Syrjai, diku u ngatërrua në përkthim. Ai solli dy – tri sinonime të një fjale, por ende ishte i paqartë, se si duhej përkthyer kjo fjalë në ngjyrimin apo konotacionin bektashian. Por baba Reshati më kish kuptuar fare mirë, se ku kërkoja të dilja unë me atë frazë dhe ja tregoi këtë sekretarit të vet. Miqtë e mi turq, që dinin shqip shumë mirë, qeshën me mrekullinë e liderit bektashian. Ndërsa ky butë - butë sikur të donte të mos zgjonte njeri nga gjumi na tha të gjithëve: “Ato fjalë që le mangët rusishtja apo shqipja i plotëson vet Ehli-Bejti”.

Si përfaqësuese e parlamentit të Azerbajxhanit, duke ndjerë nga afër pritjen e rezervuar, që më kujtoi vizitat e mija të përmallshme në shtëpinë e gjyshërve, e quajta vetem me fat të falenderoja babain bektashi, për çastet e bukura që po shijonim së bashku. Më së fundmi, unë kisha takuar dervishë dhe baballarë

bektashinj, ashtu siç kisha parë dikur të vizatuar prej literaturës sonë të vjetër. Isha lumturuar dhe këto emocione nuk do t’i ndrydhja brenda kujtesës sime vizuale, por do t’ia transmetoja edhe prindërve apo miqve të mij. Periudha e diktaturës në Shqipëri, e cila zhurmshëm u shoqërua me rrënimin e objekteve të kultit, ngjante më së shumti me periudhën tonë të diktaturës staliniste, ku jo vetëm nuk mund të manifestonim hapur për Ehli – Bejtin, por ishim të detyruar të mbartnim kujtimet e të shkuarës, në rrjedhën fatkeqe të ngjarjeve. Si në Shqipëri edhe ne, kishim mbajtur në fshehtësi, zinë e matemit, bile më kujtohet se mësuesi i këngëve në ato vite, na këndonte fshehurazi elegji për Imam Hysenin.

E pashë që kur i përmenda Imam Hysenin u mallëngjye. Fjalët e mija të fundit i bënë përshtypje të thellë, kushedi pse, ndofta i erdhi mirë që dhimbja për Hysenin, ishte e pranishme edhe atje larg në toka të Azerbajxhanit. Fare natyrshëm ai mori dorën time në duart e mëdha të tij dhe me pyeti për emrin e nënës dhe të babait. Pastaj mbylli sytë dhe nisi të bëjë një lutje për mua. E kuptova në heshtje, sepse kisha parasysht të parët e mi, që ndonëse nuk ua kërkoje, përpara se të ndahesha ata luteshin. Jam e sigurt e te fryma e tij e pastër, dhembshuria e tij në kufijtë e papërcaktuar të hyjnores, do të bënte që lutja për mua, të ngjitej shumë lart, në qiejt. Ne u çuam të gjithë. Unë e shtrëngova fort në gjoks sikur doja të merrja nga fryma e tij e shenjtë, ndërsa lideri botëror me atë mjekrën e bardhë mori natyrshëm dy- tri kokrra mollë nga tavolina aty pranë dhe më tha ti kisha për rrugës. Tek ai burrë gjithçka ishte e vërtetë. E vërtetë si Zoti, lart në qiej.



Besnikëria e përjetshme e Imam Aliut a.s

Kur pjesa më e madhe e myslimanëve ishte larguar nga Meka dhe ishte vendosur në Jatrib tashmë, idhujtarët e Mekës kuptuan se sikur Islami të lëshonte rrënjë të forta në veri të tyre dhe të bëhej i fuqishëm, do të përbente një rrezik të madh për interesat e tyre tregtare në Siri. Ata e shihnin Islamin si një rrezik që po rritej në veri. Andaj ata organizuan një mbledhje në godinën e pleqësisë së Mekës, për të kërkuat një zgjidhje që do t'i jepte fund këtij rreziku. Pas një diskutimi të gjatë, ata u pajtuan mënyra e vetme për të shpëtuar nga ky rrezik ishte vrasja e shkaktuesit të saj Muhamedit, i cili ndodhej akoma në Mekë. Kjo ide sillte edhe dilema të tjera të pazgjidhura.

Kush do ta vriste atë? Kur dhe ku? Ata i diskutuan edhe këto pyetje, propozuan shumë zgjidhje të mundshme dhe më në fund vendosën, me një konsensus të plotë, se do të zgjidhej nga një luftëtar nga secili fis mekas dhe nga fiset përreth qytetit. Të gjithë do ta sulmonin përnjëherë Muhamedin dhe do ta vrisnin para se të vinte agimi i ditës së nesërme. Ata ishin të bindur se një bashkëveprim i tillë i të gjithë fiseve do t'i linte duarlidhur Hashimitët, të cilët do ta kishin të pamundur të luftonin kundër fiseve përnjëherë si hakmarrje për vrasjen e Profetit tonë. Megjithatë i



Dërguari ishte i përgatitur për gjëra të tilla. I informuar me kohë për planin e Kurejshit nga një mysliman që e mbante fshehur besimin e tij, ai e thirri kushëririn e tij të devotshëm Ali ibn Ebu Talibin, ia tregoi atij planin e Kurejshit dhe ia rrëfeu edhe planin që kishte bërë për t'i shpëtuar kësaj gracke. Plani i tij ishte që Aliu të flinte në shtratin e të Dërguarit ndërkohë, ai vetë të largohej nga shtëpia në një rast të volitshëm. Përveç kësaj, ai i kërkoi Aliut që t'ua kthente idhujtarëve të gjithë amanetet që ia kishin lënë në besë Muhamedit dhe pastaj të largohej nga Meka për t'u takuar me të në Jethrib. Aliu i kuptoi të gjitha dhe i Dërguari e la atë në duart e Zotit. Sipas Muhamed Husejn Hajkal: Të rinjtë që Kurejshi i kishte përgatitur për vrasjen e Muhamedit, e kishin rrethuar shtëpinë e tij që të mos largohej. Në natën e Hixhretit, Muhamedi ia tregoi planin e tij Aliu ihu Ehu Talibit dhe i kërkoi që të mbulohej me harkan e gjelbërt të Profetit dhe të shtrihej në shtratin e tij. Përveç kësaj, i kërkoi të qëndronte në Mekë derisa t'ua kthente pronarëve të tyre amanetet që i ishin lënë në besë të Tij.

Idhujtarët e kishin rrethuar shtëpinë e Muhamedit. Ata hynë në shtëpi, panë se dikush ishte në shtrat dhe u siguruan se “preja” e tyre ishte aty. Momenti më i përshtatshëm që i Dërguari të largohej ishte pikërisht para mesnate, kur disa prej sulmuesve i kishte zënë gjumi. Ai heshturazi kaloi ndërmjet tyre dhe u largua nga shtëpia. Sulmuesit ishin zënë të papërgatitur dhe i Dërguari i Zotit ia doli mbanë t'i shmangej vëzhgimit të tyre. Aliu fjeti në shtratin e Profetit gjithë natën. Pak para agimit, idhujtarët hynë në shtëpi me shpatat e tyre për ta vlarë të Dërguarin por u habitën me të madhe kur në vend të tij e gjetën Aliun. Ata e kapën Aliun për ta marrë në pyetje dhe mbase për ta torturuar por prijësi i tyre u përkujtoi se Muhamedi nuk mund të kishte shkuar larg dhe se mund ta kapnin akoma nëse nuk humbnin kohë duke u përpjekur të merrnin ndonjë fjalë nga goja e Aliut. Kështu, ata e

lanë të lirë Aliun'. Kjo ngjarje njihet në historinë e Islamit me emrin “Hixhër” ose “Hixhret”.

M. Shibli, historiani i famshëm indian i Islamit, në biografinë e të Dërguarit të Zotit shkruan: ...paganët e Mekës e urrenin Muhamedin por kishin besim tek ai. Kushdo që kishte diçka të çmueshme, ia linte atij për ta ruajtur. Ai ishte “banka” e tyre. Muhamedi kuptoi për planin e Kurejshit dhe e thirri Aliun, të cilit i tha: “Zoti më ka urdhëruar të nisem drejt Jethribit. Ti do të flesh në shtratin tim dhe nesër do t'ua kthesh të gjithë njerëzve amanetet e tyre”. Kjo ishte një situatë më se e rrezikshme. Aliu e dinte se Kurejshi ishte i vendosur për ta vlarë të Dërguarin e Zotit dhe se të flije në shtratin e tij, do të thoshte të shtriheshe në kthetrat e vdekjes. Por mos vallë ishte trembur ndonjëherë Aliu nga vdekja? Pushtuesi i ardhshëm i Hajberit u shtri në kthetrat e vdekjes i qetë, siç nuk ishte shtrirë kurrë për gjumë në jetën e tij. I Dërguari nuk pati kohë t'i shpjegonte në hollësi Aliut se sa gjëra i kishin lënë amanet mekasit dhe kujt i takonin ato. Mjaftoi që t'i thoshte Aliut t'ua kthente të gjithë ato amanete pronarëve të tyre dhe Aliu e bëri këtë pa gabim. Ishte rasti i njëjtë si në darkën e “ftesës për të afërmit” në fillim të profetësisë, kur Profeti vetëm i tha Aliut t'i ftonte për darkë të parët e fisit të Hashimitëve. S'kishte nevojë për udhëzime të mëtejme. Aliu menjëherë e kuptoi se ç'kërkohej prej tij. Fakti se Profeti ia la Aliut kthimin e amaneteve që ia kishin dorëzuar mekasit, tregon se Aliu ishte i besuari dhe “sekretari privat” i Profetit të Islamit edhe para shpërnguljes për në Jethrib. Hixhreti, përveç besnikërisë së padiskutueshme të Aliut ndaj mësuesit të tij Muhamedit, e vërtetonte njëkohësisht edhe guximin e jashtëzakonshëm që kishte. Shpatat e armikut mund ta kishin vlarë Aliun, qoftë duke menduar se ai ishte Muhamedi ose thjesht nga zemërimi, kur të kuptonin se Muhamedi u kishte ikur. Ai e kishte parasysh gjithë këtë por për Aliun, asnjë rrezik nuk ishte i tepërt nëse mund t'ia shpëtonte jetën të Dërguarit të Zotit. Ishte



pikërisht kjo devotshmëri dhe ky guxim i Aliut që do ta bënte atë t'i fitojë lëvdatat e Kur'anit të Shenjtë. Libri i Zotit e ka lëvdur këtë besnikëri dhe guxim të Aliut ku thuhet: Dhe mes njerëzve ka të tillë që e shesin jetën e tyre për ta fituar kënaqësinë e Zotit...

Raziu, komentuesi i famshëm i Kur'anit në veprën Tefsir-i Kebir thotë se ky varg u shpall posaçërisht si lëvdatë për bëmat e mëdha dhe të lavdishme të Aliut në natën e Hixhretit, kur ai i mundësoi të Dërguarit të Zotit të largohej nga Meka. Falë tij, Muhamedi mundi të largohej i sigurt. Në këtë natë historike ndodhi një tregti e çuditshme dhe tejet misterioze, që ishte e para dhe e fundit e llojit të saj në gjithë historinë. Ishte një tregti mes Zotit dhe njërit nga robërit e Tij. Ky rob ishte Ali ibn Ebu Talibi. Në një natë të qetë dhe të pahënë, Zoti erdhi në "treg" si "Blerësi" që kërkonte të blinte një gjë të caktuar. Robi i tij Aliu, erdhi në këtë "treg" si "tregtar". Detyra e tij ishte ta shiste atë që Zoti e kërkonte dhe që s'ishte tjetër veçse shpirti dhe jeta e tij. Zoti e vlerësoi këtë shpirt dhe vendosi se është i shkëlqyeshëm dhe se do ta "blinte". Ai ia pagoi "çmimin" tregtarit dhe kjo pronë ndërroi duar, si në çdo tregti tjetër. Që nga ai çast, kjo pronë (jeta e Aliut) pushoi së qeni e tij dhe u bë pronë e Zotit. Me këtë mori fund tregtia mes Zotit dhe robit të tij, në kënaqësi të plotë të të dyja palëve. Kishte edhe "dëshmitarë" të kësaj tregtie dhe ata ishin engjëjt dhe yjet, mijëra prej tyre, që vështronin nga "galeritë" qiellore. Ata, me një habi të pafjalë dhe me një admirim të heshtur vështronin se si Aliu ia shiste Zotit shpirtin e tij. Kur'ani i Shenjtë u bë "zëdhënësi" i tyre për të vdekshmit e tokës dhe e shënoi atë që "dëshmitarët" e panë në këtë natë të madhe. Drejt një shpelle të quajtur Thaur, në jug të Mekes. Ata arritën tek shpella dhe hynë brenda kur ishte akoma errësirë. Pas disa orësh, ata ishin akoma të fshehur në shpellë, kur ndjekësit e tyre erdhën para saj. Sipas rrëfimeve, një merimangë kishte thurur rrjetë në hyrje të shpellës dhe një zog kishte bërë

fole. Ndjekësit ishin të bindur se sikur dikush të kishte hyrë brenda, rrjeta dhe foleja do të prisheshin. Ngase të dyja ishin të paprekura, ata arritën në përfundimin se asnjëri s'kishte hyrë brenda. Të bindur se ikanakët nuk ishin në shpellë, ata u dorëzuan dhe u kthyen në Mekë. Derisa ndjekësit diskutonin mes veti në duhej ose nuk duhej të kontrollonin brenda shpellës, Ebu Bekrin e zuri paniku dhe i tha të Dërguarit: "Ne jemi vetëm dy vetë kurse ata janë shumë. Si do të shpëtojmë sikur të hyjnë në shpellë?". I Dërguari ia ktheu: "Jo, nuk jemi dy vetë. Ka një të tretë me ne dhe Ai është Zoti". Ky rast përmendet në Kur'an, në vargun e dyzetë të kapitullit të nëntë: Dhe Zoti e ka ndihmuar atë kur jobesimtarët e patën përzënë si vet të dytë. Dhe kur ishin në shpellë, ai i tha shokut të tij: "Mos u brengos. Zoti është me ne".. Dhe Zoti zbriti qetësi mbi të... I Dërguari dhe Ebu Bekri kaluan tri ditë në shpellë. Gjatë kësaj kohe në Mekë, interesi për ta kapur të Dërguarin kishte rënë dukshëm. Në ditën e katërt, Abdullahu, djali i Ebu Bekrit, solli dy deve, me të cilat do të udhëtonin. Ebu Bekri ia ofroi njëren të Dërguarit por ai nuk e pranoi si dhuratë dhe ia pagoi çmimin saj. Pas kësaj, ai dhe Ebu Bekri u hipën deveve dhe pasi i shkuan. Mekës rreth e përçark, u nisën drejt Jetribit që ndodhej në veri. Këta dy udhëtarë e kaluan për nëntë ditë distancën mes Mekës dhe Jetribit dhe në ditën e dhjetë arritën në Kuba, një vendbanim rreth 3 km larg Jetribit, ku qëndruan në shtëpinë e Kulthum ibn Hindit si mysafirë. I Dërguari vendosi ta priste ardhjen e Aliut nga Meka, para se të hynte në Jetrib. Në ndërkohë, ai i hodhi themelet e një xhamie në këtë qytezë, ndërtimi i të cilës do të zgjaste katërmëdhjetë ditë. I Dërguari arriti në Kuba të hënë. Të enjten e asaj jave erdhi edhe Aliu. Ai ua kishte kthyer mekasve amanetet e tyre. Mësuesi i tij ishte më se i lumtur që e shihte dhe e falënderoi Zotit, i cili e kishte nxjerrë shëndoshë e gjallë nga Meka.

Përgatiti: Enea Muhameti



BEKTASHISM GAVE GOODNESS, SOLIDARITY AND PATRIOTISM TO THE ALBANIANS

“Speech by the President of the Republic, His Excellency, Ilir Meta, held at the Holy Bektashian Headquarters on 17th of January, 2019.”

“We just passed the Pan-national Year of George Castriot Scanderbeg, whose memory and honor will remain eternal!

Every 17th of January, Albanians will as always bow with pride and deep gratitude in front of the memory and works of our national leader, George Castriot Scanderbeg. The 17th of January coincides also with the realization of the First National Congress of the Albanian Bektashians, held in the Prishtë Tekke in Scrapar. This historical rally is remembered for its very important decisions in the reforming of the Bektashian community and the consolidation of the new Albanian state.

Therein was declared the independence of Bektashians in Albania and the “Albanian Bektashian Leage” was established. The first congress of the Bektashians gave its independence to one of the most important spiritual patterns of the Albanian nation.

On the 17th of January 1921, for the first time there was set the Albanian language for usage in religious rites.” – highlighted the President of the Republic.

“The Albanian patriots realized the national unification based on their ethnic identity, their com-



mon origin and language, as well as on shared ethnocultural values. This act of the Subscribers of the Independence became the leitmotif of national unification and of our religious harmony.

Bektashism, as part of our reli-

gious communities, gave goodness, solidarity and patriotism to the Albanians. It offered peace and cooperation to the Albanian brothers of other religions. The relation that this creed created with the Albanian interests, their ethnoculture and

their enlightened nationals, gradually transformed Albania into the homeland of bektashism.

We are proud that in the year 1930, the World Headquarters of Bektashism was established in Tirana, so we appreciate the fact that at its head was set the honoured Kolonjar, His Saintliness Njazi Salih Dede, the former Head of the famous Tekke of Haji Bektashi.

We have come to the World Head, precisely there where the honoured Njazi Salih Dede set the foundations and raised the holy sanctuary to the status of world representation.

During the National Renaissance, the great Naim Frashëri would counsel the Bektashian compatriots that:

“They should lead with holy words the Albanians’ struggle for freedom and not to cede from dying for the nation.”

Njazi Salih Dede is among the most brilliant examples of patriotic

men, under the Bektashian magnificence, which were born and sacrificed themselves for the nation.

We are honouring today, together, a distinguished Bektashian cleric and martyr of the nation. A patriot who resolutely said “No!” to the fascist occupation, and for whom – as it is with all the Bektashians – Albania remains over the rest.

Njazi Salih Dede has taken already taken an important place in the infinite pantheon of all the patriotic clerics who have not spared even their own lives for the maxim “No religion without the nation”. *For all these reasons, it is my pleasure to cast upon the pride of Bektashism and the martyr of the nation, Njazi Salih Dede, the high title of “Honour of the Nation”.*



On the 17th of January 1921, for the first time there was set the Albanian language for usage in religious rites.” – highlighted the President of the Republic.

“The Albanian patriots realized the national unification based on their ethnic identity, their common origin and language, as well as on shared ethnocultural values.

This act of the Subscribers of the Independence became the leitmotif of national unification and of our religious harmony. Bektashism, as part of our religious communities, gave goodness, solidarity and patriotism to the Albanians. It offered peace and cooperation to the Albanian brothers of other religions. The relation that this creed created with the Albanian interests, their ethnoculture and their enlightened nationals, gradually transformed Albania into the homeland of bektashism. We are proud that in the

year 1930, the World Headquarters of Bektashism was established in Tirana, so we appreciate the fact that at its head was set the honoured Kolonjar, His Saintliness Njazi Salih Dede, the former Head of the famous Tekke of Haji Bektashi.

We have come to the World Head, precisely there where the honoured Njazi Salih Dede set the foundations and raised the holy sanctuary to the status of world representation. During the National Renaissance, the great Naim Frashëri would counsel the Bektashian compatriots that: “They should lead with holy words the Albanians’ struggle for freedom and not to cede from dying for the nation.” Njazi Salih Dede is among the most brilliant examples of patriotic men, under the Bektashian magnificence, which were born and sacrificed themselves for the nation.

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.130 SHKURT 2019

